

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit Msc. në E Drejtë Publike
Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho

Dr. Bledar Mustafaraj





(Qershor/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc E Drejtë Publike

| Tabela e të dhënave për programin e studimit | | |
|--|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marëdhënieve Ndërkombëtare |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Urdhër Nr. 346, datë 17/09/2015 |
| 4 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë | Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 38, datë 19/05/2017 |
| 5 | Titulli i programit të studimit: | Master Shkencor në E Drejtë Publike |
| 6 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 7 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite/4 semestra |
| 8 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 9 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Kohë e plotë |
| 10 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 11 | Programi ofrohet nga institucioni | Ofrohet nga institucioni |
| 12 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | N/A |
| 13 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | N/A |
| 14 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | N/A |
| 15 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 7 |
| 16 | Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë | |
| | 2017-2018 | 107 |
| | 2018-2019 | 107 |



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në E Drejtë Publike

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (përmendur në vijim me inicialet UMSH) është krijuar në vijim të VKM Nr. 177, datë 19/02/2009 “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit të arsimit të lartë SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, fillimisht e njohur si Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë”. Me urdhrin Nr. 278, datë 19/05/2017 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit është miratuar ndryshimi i statusit të këtij institucioni nga Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë” në Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Institucioni është në pronësi të personit juridik “Qendra Mesdheu” sh.p.k., e cila ka nisur veprimtarinë e saj në bazë të vendimit Nr. 42, datë 06/07/2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

UMSH përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, të cilët organizojnë studime të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave e Master Profesional. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare zhvillon programet: Bachelor në Juridik, Master i Shkencave në e Drejtë Publike, Master i Shkencave në e Drejtë Civile dhe Tregtare, Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile në Studime Evropiane dhe Studime Mesdhetare.

UMSH është akredituar institucionalisht si dhe janë akredituar programet e tij të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Profesional, me urdhrat Nr. 124, datë 29/03/2012 dhe Nr. 291, datë 11/07/2012 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

Programi i studimit “Master i Shkencave” në fushën e të Drejtës Publike është çelur në vijim të urdhrit të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit Nr. 346, datë 17/09/2015 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në të Drejtë Publike”, në institucionin “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”. Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2015-2016 dhe është pjesë e programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Programi “Master Shkencor në të Drejtë Publike” është akredituar me vendimin Nr. 38, datë 19/05/2017 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është data 31/07/2019.

UMSH ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në e Drejtë Publike, ku me shkresën Nr. 163/3 Prot., datë 18/09/2018 të kësaj Agjencie ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer lidhur me qëllime të riakreditimit.

Përsa i përket numrit të studentëve, siç është verifikuar edhe nga GVJ:


- Viti i parë 2017-2018 ka pasur 105 (njëqind e pesë) studentë të cilët kanë ndjekur studimet dhe janë diplomuar në nivelin MSc “E drejtë Publike” në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.
- Viti i dytë 2018-2019 ka 106 (njëqind e gjashtë) studentë që ndjekin studimet dhe në nivelin MSc “E drejtë Publike” në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Guida e Studentit është element orientues që Institucioni e ofron së bashku me zyrat përkatëse në funksion të studentit.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho dhe Dr. Bledar Mustafaraj si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistja e ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 14.06.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 21.06.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:



Memo

Për Komentin që i përket konkluzionit të vlerësimit në faqen 32, pika 6, të RVJ, GVJ merr në konsideratë shpjegimin e institucionit dhe saktëson gjetjet e tij si dhe konkluzionin përkatës, përfundim i cili është reflektuar në rubrikën 7 “Programi i studimit, organizimi i tij”, të këtij raporti. GVJ thekson se rekomandimi lidhet me përshtatjen e syllabus-eve në tërësi, pra nga secili pedagog sipas lëndës respektive, me modelin që përcakton VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe i qëndron këtij rekomandimi. Gjithashtu, në secilin syllabus të përcaktohet saktë detyrimi i studentëve për frekuentimin e detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve (në përqindje). Gjetjet e GVJ janë bazuar në syllabus-et e vëna në dispozicion nga IAL dhe çmujmë se rekomandimi i shërben pozitivisht përmirësimit të punës në institucion.

Për Komentin që i përket konkluzionit të vlerësimit në faqen 39, pikat 4 dhe 5 të RVJ, GVJ merr në konsideratë shpjegimin e institucionit, por u qëndron gjetjeve dhe sugjerimeve të bëra, me qëllim përmirësimit të sistemit të të dhënave në institucion dhe punës në tërësi të tij.

Lidhur me pikën 4 që bën fjalë për mungesën në regjistër të të dhënave për gjuhën e huaj dhe nivelin përkatës, që zotëron secili student i regjistruar, kjo mangësi ka rezultuar nga këqyrja fizike që iu bë regjistrit në prani të stafit administrativ (punonjëseve të sekretarisë) si dhe specialistes së ASCAL. RVJ ka gjetur me vend të sugjerojë rregullimin e kësaj mangësie, duke qenë se në dosjet e regjistrimit të studentëve dokumenti i njohjes së gjuhës së huaj ishte i administruar.

Sa i përket pikës 5 të faqes 36 të RVJ, nga takimi i realizuar me grupin e përzgjedhur të studentëve, nga pyetja direkte që iu bë, ata konfirmuan gojarisht se nuk e njihnin figurën e dekanit të studentëve. Ky fakt është pasqyruar dhe në procesverbalin e mbajtur nga specialistja e ASCAL. Duke qenë se kjo figurë ekziston në strukturën e UMSH, referuar si RVB ashtu dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga vizita në institucion, GVJ ka gjetur me vend të evidentojë këtë fakt me synimin që IAL të shtojë përpjekjet për t’i bërë më të njohura strukturat e tij, të cilat në fakt janë të ngritura dhe ekzistojnë.

Për Komentin që i përket konkluzionit të vlerësimit në faqen 45, pika 1, të RVJ, GVJ vë në dukje se në rubrikën që bën fjalë për “Kërkimin shkencor”, të këtij raporti, nuk gjendet konkluzioni për të cilin janë shfaqur pretendimet përkatëse, ndaj nuk e merr në konsideratë atë.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të mbikëqyret ndarja e barabartë në kreditet e 2 viteve me qëllim shmangien e mbingarkesës në vitin e dytë të studimeve;
- b) Të qartësohet raporti dhe ndarja e detyrave midis shefit të departamentit dhe Koordinatorit të Programit Master;
- c) Të shihet si mundësi parashikimi si i detyrueshëm i pjesëmarrjes së Përgjegjës të Departamentit në Komisionin e Rekrutimit;
- d) Të shikohet mundësia për realizimin e praktikës në institucione si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritit, etj.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin sipas pikës (a), institucioni ka bërë parashikime të qarta në aktet e brendshme të funksionimit të tij, duke përcaktuar ndarjen e barabartë të krediteve prej 60 të tilla në çdo vit studimi. Ky rregullim vërehet në nenin 46 të Rregullores së Organizimit të UMSH si dhe në planet mësimore të dy viteve të fundit akademike.

Përsa më lart, ky rekomandim është plotësuar nga ana e IAL.

- b) Për rekomandimin sipas pikës (b), institucioni ka realizuar ndryshimet përkatëse në aktet e brendshme të UMSH, ku parashikohen funksioni dhe detyrat konkrete të Koordinatorit të Programit të Masterit. Ndryshime të tilla pasqyrohen në nenin 22/1 të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në nenet 7/1-3, 8/1, 9/1, 20/3, 23 të Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në të Drejtë Publike. Rekomandimi është plotësuar duke u qartësuar roli i Koordinatorit dhe në ndryshimet strukturore brenda fakultetit.

Në këtë kuptim, ky rekomandim është plotësuar nga ana e IAL.

- c) Për rekomandimin sipas pikës (c), institucioni ka bërë ndryshimet e nevojshme në aktet e brendshme të funksionimit të tij, ku është parashikuar pjesëmarrja e Përgjegjës të Departamentit në procesin e rekrutimit të personelit akademik, në mënyrë të detyrueshme. Plotësimi i këtij rekomandimi gjen shprehje në nenin 38, gërmat c, d, të Statutit të UMSH, nenin 20, gërmat c, k, të Rregullores së Organizimit të UMSH, nenin 14, gërma d, të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, nenin 8, gërmat c, k, të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Departamentit të së Drejtës Publike.

Rekomandimi rezulton të jetë plotësuar nga institucioni.

- d) Për rekomandimin sipas pikës (d), institucioni ka vepruar duke bërë së pari ndryshime në aktet e brendshme të tij e konkretisht neni 38, gërma i, i Statutit të UMSH, neni 67/3-6 të Rregullores së Organizimit të UMSH, nenet 14, gërma i dhe 45/1-6 të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 8, gërma i, i Rregullores për Organizimin dhe Punën e Departamentit të së Drejtës Publike. Në vijim të këtyre plotësimeve në aktet e brendshme, në kuadër të programit praktika është realizuar në institucione të tilla si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritit, etj., sipas rekomandimit të lënë nga BA. Kryerja e praktikës në këta institucione vërtetohet me dokumentacionin përkatës të depozituar pranë Përgjegjës të departamentit dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës.

Konstatohet se rekomandimi është plotësuar nga institucioni.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Me urdhrin Nr. 278, datë 19.05.2017, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar ndryshimi i statusit të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë nga Shkollë e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë” në Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përfaqëson një nga fakultetet kryesore të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” (UMSH).

Aktet rregullativë të IAL-së, Statuti dhe Rregulloret e Institucionit, janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet normative në fuqi, siç është konstatuar edhe nga GVJ.

Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Rezulton se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka bërë një studim analitik të tregut të punës. Nga ky studim rezulton se Masteri i Shkencave në E Drejtë Publike është një program i kërkuar pikërisht nga juristë të cilët duan të thellohen në fushën e të drejtës publike, me qëllimin kryesor të punësimit pranë organeve publike dhe jo-publike, ose pranë institucioneve dhe administratës gjyqësore, në fushën e ndërmjetësimit dhe përmbartimit, zyrave të avokatisë dhe noterisë, personave juridikë me qëllim jofitimprurës etj..


Ky program studimi dhe përgatitja e dokumentave strategjikë janë përpiluar edhe në konsideratë të zhvillimit socialo-ekonomik të vendit tonë.

Siç shfaqet në dokumentat orientues të përgatitura nga IAL nën vlerësim, programi i studimit synon t’u ofrojë studentëve përvetësimin e kulturës ligjore bazë, si dhe pajisjen me instrumentet themelore të nevojshme për të përditësuar aftësitë e tyre, kërkim të pavarur shkencor në fushën e studimeve të së drejtës publike dhe në mënyrë specifike, të marrëdhënieve midis shtetit dhe të drejtës, si dhe organizimi i aktiviteteve plotësuese për zhvillimin e mëtejshëm e aftësive të veçanta dhe kapacitetet interpretuese të studentëve. Etika profesionale, logjika dhe argumentimi juridik janë aspekte plotësuese të këtij programi të evidentuara kundrejt GVJ nëpërmjet materialeve strategjikë dhe rregullativë të IAL-së. Duke konsideruar edhe ndryshimet thelbësore të reformës në drejtësi, nevoja për profesionistë të informuar përshtatshëm mbi rregullimet e reja kushtetuese është e madhe.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. | |
| Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; | Programi i studimit MSc në “E Drejtë Publike”, i ofruar nga Departamenti i së Drejtës Publike i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” dhe të planit strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar. Në përfaqje me sa më sipër, programi i studimit Master Shkencor në fushën e të Drejtës Publike synon ofrimin e njohurive të thelluara në fushën e të drejtës publike që ka në fokus marrëdhëniet midis shtetit dhe të drejtës në raport me individin dhe shoqërinë. Sipas rregullores së programit Master |
| Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; | |
| Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; | |
| Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | |

| | |
|---|---|
| | <p>Shkencor dhe strukturës së planit mësimor evidentohet se qëllimi i programit është pajisja e studentëve me njohuritë të avancuara të karakterit shkencor e profesional në fushën e të drejtës publike, duke synuar formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet lëndëve të programit me qëllimin për të punuar në sektorë të rëndësishëm brenda fushës së drejtësisë. Në kuadrine ndryshimeve të reformës në drejtësi, nëvoja për profesionistë të formuar në këtë aspekt, është e madhe.</p> <p>Programi i studimit është konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.</p> <p>Programi i studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> |
| <p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> | <p>Programi Master i Shkencave në Drejtë Publike është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH-së por gjithashtu edhe me Planin Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Kjo reflektohet në punën e vazhdueshme për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik, vazhdimësinë dhe rritjen e bashkëpunimeve, nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.</p> <p>Në linjë me objektivat e strategjisë për zhvillimin e institucionit është edhe organizimi i programit të studimit MSc në drejtim të pajisjes së studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale por edhe me shprehje të transferueshme dhe ndihmëse duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për punësim në disa sektorë.</p> |
| <p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Publike” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njësisë ku zhvillohet ky program studimi. Ky program studimi MSc. është në përputhje dhe me emërtimin e titullit të diplomës përkatëse (të realizuar për dy vite akademike me 120 ECTS gjithsej). UMSH ka përgatitur programin e nivelit të dytë të studimit 5 vjeçar referuar GVJ, si në stadin aktual të një drafti.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Publike, i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit</p> |
| <p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në</p> | <p>Programi i studimit MSc. synohet të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me planin e zhvillimit strategjik të programit MSc. “E Drejtë Publike” dhe politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master. Konkretisht, synohet:</p> |


| | |
|---|--|
| <p>nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> | <p>Rritja e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimi i kurrikulave, mbështetja për rritjen e zhvillimit shkencor, përfshirja e studentëve në aktivitete të ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti ka hartuar planin strategjik në nivel institucional i cili reflektohet në programin “Master i Shkencave në E Drejtë Publike” Institucioni është angazhuar në përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> - formimit të pedagogëve me trajnime lidhur me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor - inkurajimit të pedagogëve për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore e shkencore dhe nxitjen e debatit mediatic në fushat përkatëse - zgjerimit të shërbimeve mbështete infrastruktorre e teknologjike si interneti apo portali i pedagogut, përfshirë edhe pasurimin e bibliotekës, etj. |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në e Drejtë Publike është hartuar dhe administrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. 2. Programi i studimit MSc. “E Drejtë Publike”, është i përshtatshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit dhe kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara. 3. Programi i studimit Mastër Shkencor në të Drejtë Publike rezulton në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit në tërësi. 4. Nevojat e tregut dhe kompleksiteti i çështjeve të trajtuara do të kërkonin organizimin e programit në funksion të një specializimi të mëtejshëm, duke e përcaktuar profile specifike të programit në fushën e së drejtës publike, element i cili do t’u jepte studentëve mundësinë e një formimi më të thelluar. 5. Programi në tërësinë e tij do të kishte mundësi gjykimi më efektiv në qoftë se Insitucioni, nëpërmjet ekspertëve të jashtëm, do të realizonte një vlerësim të pavarur të programit të studimit dhe të programeve të lëndëve mësimore. | |

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkimore

Institucioni i Arsimit të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është i organizuar në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Pas riorganizimit të departamenteve me anë të Urdhërit Nr.17 datë 19.12.2014, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare është një prej tre fakulteteve që përbejnë UMSH i përbërë nga tre departamente (ref. Tabela 1):

- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i të Drejtës Publike
- Departamenti i Marrëdhënies Ndërkombëtare




Fakulteti ka si qëllim zhvillimin akademik të çdo studenti për në funksion të problematikave aktuale juridike në shoqëri dhe pajisjen e studentëve me aftësitë teknike në fushat e studimit. Gjithashtu, fakulteti punon për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Aktualisht, Fakulteti ofron 2 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 1 program të Ciklit të Dytë Master Profesional. Përbushja e kësaj detyre mundësohet përmes angazhimit të një personeli akademik të përbërë nga 41 pedagogë, nga të cilët 28 të brendshëm dhe 13 të jashtëm.


Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Publike ka si qëllim kryesor formimin dhe diplomimin e juristëve në fushën e të drejtës publike dhe të promovojë kërkimin shkencor në këtë drejtim. Personeli mësimdhënës ndahet në personel akademik efektiv (me kohë të plotë / PAE) dhe personel akademik me kontratë (me kohë të pjesshme / PAK). Drejtuesit e njësive bazë dhe dekanatit janë pedagog të brendshëm dhe punojnë me kohë të plotë në institucion.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Stafi akademik i departamentit të së Drejtës Publike me kohë të plotë dhe të pjesshme përbëhet nga pedagog me tituj dhe grada shkencore, konkretisht, 1 Profesor Doktor, 2 Profesorë të asociuar, 6 doktorë nga të cilët 1 i ka mbaruar studimet e doktoraturë në vendet e Evropës perëndimore, 6 me Msc., një pjesë prej të cilëve janë në proces doktorature (referoju tabelës 1 dhe 1.1). Në programin e studimit Msc. “E Drejtë Publike” programi MSc i ofruar është një i vetëm, pa orientime në profile. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton ndryshime të vogla në përbërjen e stafit akademik ndër 2 vitet akademike që janë objekt i këtij riakreditimi (2017-2019). Këto ndryshime janë bërë duke ruajtur standardet akademike në lidhje me titujt dhe gradat shkencore që stafi akademik efektiv duhet të ketë.

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|--|
| Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përbushjen e misionit të tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p> | <p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka si mision kryesor edukimin e brezit të ri dhe rritjen e kërkimit shkencor.</p> <p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni është organizuar dhe funksionon në bazë të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.</p> <p>IAL ka në përbërje të tij tre fakultete nga të cilët, Fakulteti Juridik ka në përbërje tre njësi, përkatësisht departamentin e të Drejtës Publike, departamentin e të Drejtës Civile dhe departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</p> <p>Secila prej këtyre njësive bazë, funksionon në përputhje me objektivat dhe misionin e tyre. Këto njësi, e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre, në realizimin e synimeve, strategjive të njësisë kryesore, duke bashkërenduar dhe punën ndërmjet tyre.</p> <p>Departamentet kanë në përbërjen e tyre më shumë se 7 anëtarë efektiv si personel akademik dhe më shumë se 3 anëtarë të personelit me gradën shkencore “Doktor” në përputhje me kërkesat ligjore.</p> |
| Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve. | |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p> | <p>Në drejtimin e njërive bazë dhe kryesore është zgjedhur personel akademik me përvojë të gjatë akademike dhe personalitete të njohura të fushës. Në përputhje me rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në E Drejtë Publike neni 6 shefi i departamentit është përgjegjës për programin e studimit Siç u evidentua gjatë vizitës së GVJ, Departamenti zhvillon mbledhje të përjavshme, zakonisht ditën e mërkurë, në lidhje me çështjet dhe problematikat e ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p>Departamenti si njësi bazë propozon kërkesat kualifikuese dhe profilin profesional të pedagogëve që do të angazhohen në programin, në përputhje me ngarkesën mësimore dhe profilin e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi. Përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” rezultojnë rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit. Kriteret bazë përcaktohen nga njësi përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Me pas është Rektori i cili ngre komisionin që zhvillon procedurën e konkurimit. Ky i fundit jep edhe miratimin final. Sipas RVB-së Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i së Drejtës Publike është i organizuar në përputhje me kërkesat ligjore, duke qenë të tilla edhe aktet rregullative të Institucionit. 2. Universteti Mesdhetar i Shqipërisë përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku çdo fakultet përbëhet nga tre njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje tre departamente, përkatësisht, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. 3. Në departamentin ku është organizuar programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Publike” për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik, ndër të cilët me kohë të plotë (PAE) 9 pedagogë, ndërsa me kontratë (PAK) 3 pedagogë. Për vitin paraardhës 2017-2018 janë 11 anëtarë të personelit akademik, ndër të cilët me kohë të plotë (PAE) 8 pedagogë, ndërsa me kontratë (PAK) 3 pedagogë 4. Sipas akteve rregullative të UMSH rezultojnë se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit dhe kriteret bazë të përcaktuara nga njësi përgjegjëse. Këto kritere më pas miratohen nga autoriteti më i lartë drejtues i Institucionit (Rektori). 5. Për vitin akademik 2018-2019 nga 9 pedagogët efektivë, 1 ka gradën shkencore dhe titullin akademik “Profesor”, 2 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 4 prej tyre ka gradën shkencore (Dr). | |

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Për realizimin e programit të studimit, Institucioni ka angazhuar një staf akademik të përbërë me personel efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar.

Personeli akademik i Departamentit të së Drejtës Publike ndahet në tre kategori: personel akademik, personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personel administrativ. Përsa i përket personeli akademik, ata kryejnë veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative. Departamenti përbëhet nga 15 anëtarë të personelit akademik, nga të cilët 9 anëtarë janë PAE dhe 6 anëtarë janë PAK. Përsa i përket raportit midis gjinive në Departament, rezulton se anëtarë PAE janë 5 anëtarë meshkuj dhe 4 anëtare femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 3 anëtarë meshkuj dhe 3 anëtare janë femra (ref. Tabela 1.1).

Në programin e studimit Master i Shkencave në E Drejtë Publike për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik në nivel Fakulteti, nga të cilët nga të cilët 9 anëtarë janë PAE dhe 3 anëtarë janë PAK. Përsa i përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezulton se PAE janë 4 anëtarë meshkuj dhe 5 anëtare femra, ndërsa nga PAK, janë 2 anëtarë meshkuj dhe 1 anëtare femër (ref. Tabela 3).

Personelit akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit respektive të studimeve e tejkalon masën 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program, duke rezultuar kështu në përputhje me kërkesat ligjore.

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat e nevojshme në lidhje me përbërjen e stafit dhe titujt akademik dhe gradat shkencore për vitet 2017-2019, të cilat u vunë në dispozicion të gjitha dhe pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Anekset e këtij raporti. Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion rezulton se të gjithë anëtarët kanë kontrata të rregullta dhe mjaft të plota si edhe njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Ngarkesa e personelit akademik të UMSH-së përfshin ngarkesën në veprimtarinë mësimdhënëse, në veprimtarinë shkencore, si dhe në angazhime të tjera administrative. Pjesë e ngarkesës janë dhe veprimtaritë në kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me kriteret ligjore si edhe procedurat rregullative të UMSH-së. Rekrutimi i punonjësve të rinj realizohet nga një komision ku marrin pjesë Rektori, Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës "Mesdheu". Përparësi i jepet personelit më të kualifikuar në titujt e grada dhe edukim në universitete të huaja.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një ndër tre Fakultet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, i cili përbëhet edhe nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Çdo fakultet përbëhet nga tre njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje tre departamente, përkatësisht, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor zotëron kualifikimet e duhura për qëllimet e përmbushjes së detyrave përkatëse. Titullarët e lëndëve janë të gjithë më grada e tituj. Personeli i programit është pjesë e Departamentit të Shkencave Juridike e si rrjedhojë është në kontakt e shkëmbim akademik në rradhë të parë me personelit tjetër të Departamentit dhe të 2 departamenteve të tjera më afërsi në fushën e studimit si Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion kërkoi të njëjët me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi për të gjithë periudhën e vlerësimit (2017-2019). Dokumentacioni përkatës u mundësua nga strukturat përkatëse të institucionit dhe GVJ e aksesoi këtë informacion në funksion të hartimit të këtij raporti. (Tabela 3).

Nga të dhënat e dokumentacionit rezulton se për vitin 2018-2019 personeli efektiv është në masën e rreth 75% titullarëve të lëndëve të programit; titullarë janë vetëm personel më grada e tituj. Raporti i pedagogëve efektivë (PAE) me pedagogët me kontratë (PAK), në kategorinë e titullit Prof. Asoc. është 4/0, në kategorinë Doktor është 5/3.

Për vitin 2017-2018 personeli efektiv ka qenë në masën e rreth 72% titullarëve të lëndëve të programit; titullarë janë vetëm personel më grada e tituj. Raporti i pedagogëve efektive (PAE) me pedagogët me kontratë (PAK), në kategorinë e titullit Profesor ka qenë 1/0, në kategorinë Prof. Asoc. ka qenë 4/0, në kategorinë Doktor ka qenë 3/3.

Nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ rezulton se ngarkesa mësimore referuar këtij programi rezulton në 640 orë mësimore, nga të cilat 630 mbulohe nga PAE dhe 210 nga PAK, duke u mbuluar kështu 75% e ngarkesës nga PAE. IAL zbaton udhëzimet në fuqi për shpërndarjen e ngarkesës së prdagogëve. Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion gjatë vizitës, rezulton se pedagogët nuk mbulojnë më shumë se tre lëndë,

Në këtë kuadër GVJ gjykon se ka një trend stabil në kualifikimin e personelit akademik me një trend të vogël përmirësues.


Të dhëna të tjera në lidhje me moshën, grada e tituj sipas kategorive, është i identifikuar në tabelat në Anexin e Raportit.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|---|
| Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> | <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit zotëron kualifikimet e duhura për qëllimet e përmbushjes së detyrave përkatëse. Titullarët e lëndëve janë të gjithë më grada e tituj. Ndërkohë titullarët janë të asistuar edhe nga personel akademik që është pa gradën doktorale ose ende në program doktore.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i departamentit të së Drejtës Publike bashkëpunon dhe kontribuon në realizimin dhe zbatimin e strategjisë për zhvillimin e UMSH.</p> |
| Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> | <p>Çdo anëtar i departamentit merr pjesë në hartimin e kurrikulës duke patur përgjegjësinë kryesore për hartimin dhe përpunimin. Procesi i hartimit dhe miratimit të kurrikulave është bazuar tek parimet dhe kriteret akademike të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë, udhëzimet e ASCAL-it, Statuti dhe Rregullorja e Institucionit. Nga ana procedurale procesi i organizimit dhe diskutimi i kurrikulave për ciklet e studimeve që ofrohen realizohen në departament nga njësia bazë.</p> <p>Për programin e studimit MSC në E Drejtë Publike në nivel departamenti secili nga pedagogët jep argumenta shkencor mbi syllabusin e përgatitur. Nga verifikimi në institucion, rezulton që zhvillohen mbledhje javore të anëtarëve të Departamentit ku diskutohen mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm të programeve mësimore.</p> <p>Sipas Statutit dhe Rregullores organizative të UMSH-së rezulton se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit. Sipas RVB-së kërkesat bazë përcaktohen nga njësia përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Më pas është Rektori i</p> |




| | |
|---|---|
| | <p>cili ngre komisionin që zhvillon procedurën e konkurimit. Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni. Nga këto të dhëna rezulton se rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto procedura i janë evidentuar GVJ-së gjatë vizitës në Institucion, edhe në kuadrin e përmirësimeve ndaj akreditimit të fundit institucional para dy vitesh.</p> |
| <p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p> | <p>Statuti i UMSH përcakton dhe rregullon veprimtarinë e institucionit. Në të përcaktohen rregullat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme. Nga vizita dhe takimet që GVJ zhvilloi në zyrën e personelit, rezultoi se rekrutimi i personelit akademik është në përputhje me këtë akt dhe rekrutimi i tij është transparent, siç është edhe evidentuar në shpalljet publike në <i>ëeb-site</i>-in e Institucionit.</p> <p>Siç është evidentuar edhe nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ, para fillimit të çdo viti akademik, njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcakton kërkesat për personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik, miratohet nga Dekani dhe Rektori. Vetëm pas këtyre hapave thirrja publikohet online në faqen zyrtare të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”, në median elektronike dhe të shkruar.</p> <p>Në nivel numerik, për vitin 2018-2019, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë MSC në E Drejtë Publike përbën 75% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve (9 PAE dhe 3 PAK). Për vitin 2017-2018 personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë MSC në E Drejtë Publike përbënte 72% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve (8 PAE dhe 3 PAK).</p> <p>Duke iu referuar numrit të orëve, gjithnjë përqindja mbetet e pandryshuar. Nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ rezulton se ngarkesa mësimore referuar këtij programi rezulton në 640 orë mësimore, nga të cilat 630 mbulohen nga PAE dhe 210 nga PAK, duke u mbuluar kështu 75% e ngarkesës nga PAE.</p> <p>Përsa i përket vlerësimit të personelit, UMSH ndjek një procedurë vlerësimi për personelin akademik i cili përfshin të dhënat që vijnë nga vetëvlerësimi për punën dhe aktivitetin në IAL, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit, vlerësimi i dekanit të fakultetit, vlerësimi i administratorit dhe pyetësorët e studentëve. Të gjitha këto vlerësime, realizohen me mbështetjen e NJSBCKZH, dhe u bëhen me dije personelit nga drejtuesi direkt i tij në fund të çdo viti akademik. Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore. Institucioni mban një bazë të të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit, si edhe të njoftimeve për punë.</p> |
| <p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p> | |




| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p> | <p>Përgjegjësi i programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Publike” ka titullin shkencor “Profesor i Asociuar” dhe ka eksperiencë të gjatë akademike. Është personel i punësuar me kohë të plotë (PAE). Titullarët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik 2018-2019, “Master i Shkencave në të Drejtë Publike”, nuk ka me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar” (4 PAE dhe 0 PAK) dhe 8 me gradën “Doktor” (5 PAE dhe 3 PAK). Sipas pikes 3 të nenit 56 të LAL 80/2015, titullarët e lëndëve duhet të jenë të kategorisë Profesorë të Asociuar ose Profesorë, kështu që kjo pikë rezulton pjesërisht e papërbushur, duke qenë se, nga 12 lëndë të programit, në tetë prej tyre titullarët mbajnë gradën shkencore “Doktor”. Autoritetet drejtuese rezultojnë me tituj akademik, duke qenë të angazhuar me kohë të plotë në Institucion. Lidhur me praktikën profesionale, Institucioni i ofron studentit mundësinë për të zgjedhur vetë vendin e realizimit të praktikës profesionale, duke i ofruar mundësinë që të aksesojë Institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Sipas dokumentacionit të administruar gjatë vizitës në institucion rezulton se si pedagog mbikqyrës është vetëm një. Duke pasur në konsideratë numrin e studentëve si edhe standardet shtetërore, rezulton se ky kriter duhet përmirësuar.</p> |
| <p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p> | <p>Nga RVB dhe nga verifikimi në institucion (intervista me personelin akademik dhe me studentët) rezulton se studentët që në fillim parashtrajnë fushën në të cilën do të realizojnë tezën për marrjen e diplomës. Për çdo rast sigurohet pedagogu udhëheqës për studentët si dhe zhvillimi i seancave metodologjike. Studentët konfirmuan informacionin e dhënë nga Institucioni. Në referim edhe të të dhënave për personelin akademik në këtë program studimi, pedagogu udhëheqës ka titullin “Profesor i Asociuar” ose edhe gradën “Doktor/PhD”. Rezultoni se asnjë udhëheqës nuk mbikëqyr më shumë se 10 studentë në këtë program studimi, siç u konstatua edhe nga GVJ në Institucion. Gabimisht është referuar në RVB në numrin 5 si kufizim maksimal, duke qenë se edhe rregullorja e UMSH-së përcakton në 10 numrin maksimal të udhëheqjeve.</p> |
| <p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p> | <p>Temat e trajtuara janë brenda fushës studimore-kërkimore që ofron programi i studimit. Të gjithë udhëheqësit kanë njohuri të avancuara dhe të thelluara për zhvillimin e kërkimit dhe hartimin e tezës për këtë program studimi.</p> |
| <p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për</p> | |

| përmbushjen e misionit të tij. | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> | <p>Nga vizita në Institucion afirmohet se Institucioni ka një angazhim të përshtshëm të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e qëllimeve formuese të programit siç mund të jetë kërkimi i pavaruar i burimeve nëpërmjet sistemit online të bibliotekës. Studentët asistohen nga stafi i bibliotekës nën drejtimin e punës nga lektori i lëndës</p> <p>Nga ana e Institucionit rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve. Nga verifikimi i GVJ rezulton se disa pedagogë mbulojnë disa detyra administrative dhe po ashtu nga stafi administrativ mbulohe me shumë detyra.</p> |
| Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p> | <p>Sipas informacionit të marrë në institucion e në konsultim me kontratat e punës rezulton që në lidhje si me personelit akademik të brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm ndiqen rregullimet në fuqi (deri në kohën e këtij vlerësimi) në lidhje me normën e ngarkesës mësimore. Udhëzimi nr. 29, i datës 10.09.2018 i Ministrit të Arsimit parashikon një sasi orësh dhe lëndësh më të limituar se parashikimet rregullative të UMSH. Megjithatë, duke u bazuar në ngarkesën që na ka dhënë IAL për stafin akademik të angazhuar në kete program stumi rezulton se një pedagog mbulon 1 deri në 3 lëndë.</p> <p>E njëjta gjë nuk verifikohet duke patur si referencë matëse orët mësimore, duke qenë se kemi disa raste ku tejkalohe ngarkesa Udhëzimi i sipërpërmëndur. Ky konstatim në lidhje me mbingarkesën në orë mësimore rezulton sidoqoftë në përputhje me aktet rregullative e brendshme të UMSH-së.</p> <p>Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në miratimin e planit mësimor për çdo vit akademik me pedagogët përkatës për çdo lëndë, mbështetur në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 20 si dhe Rregulloren e Fakultetit FSHJMN. Ngarkesa mësimore dhe organizimi e drejtimi i tyre për programin e ciklit të dytë të studimit, vlerësohet me orë mësimore siç është evidentuar nga Institucioni nëpërmjet dorëzimit të dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ.</p> |
| Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p> | <p>- Nga verifikimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezultoi se kjo e fundit disponon një bazë të hollësishme të dhënash për anëtarët e personelit akademik: ata kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin Dokumenti i identitetit, Dokumenti që vërteton punën e kryer më parë, Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore, Diploma Universitare dhe lista e notave, Diploma dhe dokumente të tjera të gradave dhe titujve shkencorë, si dhe të kualifikimeve të tjera, Libreza shëndetësore, Adresa e vendbanimit, Lista e botimeve, artikujve dhe kërkimeve shkencore.</p> <p>Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion, Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore</p> |

rezulton se Fakulteti dhe njësitë bazë dispozojnë listën e plotë të personelit akademik.
Në drejtim të kriterëve dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, ato janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Institucionit. Thirrjet janë publike në përmbushje të këkesave të kuadrit ligjor në fushën e arsimit të lartë dhe kërkesave të Kodit të Punës.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve dhe të politikave të zhvillimit të institucionit.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc. “E Drejtë Publike” për vitet akademike 2017-2019 ka ndryshuar lehtësisht në numër duke u rritur dhe në angazhimin në realizimin e programit mësimor. Nga analiza e të dhënave që gjenden në RVB dhe nga dokumentacioni që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, rezulton që raporti ndërmjet PAE dhe PAK për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 është brenda standardeve.
3. Titullarët e lëndëve nuk janë të gjithë personel akademik efektivë dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë në rolin e titullarëve të lëndëve përbëhet nga pedagogë që mbajnë grada shkencore. Ky aspekt rezulton jo në përputhje me LAL 80/2015 (neni 56) ku titullarët duhet të jenë me tituj akademik (Prof. dhe Prof. Asoc.)
4. GVJ vlerëson se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik.
5. Institucioni realizon vlerësim nga ana e studentit të programit nëpërmjet aplikimit i pyetësorit dhe fokus grupeve. Vlerësimi realizohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë por edhe në nivel Fakulteti e Rektorati nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit.
6. Rezulton se disa pedagogë mbulojnë disa detyra administrative dhe po ashtu nga stafi administrativ mbulohen më shumë detyra. Këshillohet rritja e numrit stafit administrativ në mënyrë që të lehtësohen detyrat e pedagogëve të ngarkuar me këto detyra dhe e stafit administrativ aktual.
7. Rekomandohet të evidentohet më qartë procedura në konsultimin me pedagogët dhe shpërndarjen e ngarkesës në fillim të secilit semestër nga ana e Përgjegjësit të Departamentit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Në përputhje me aktet rregullativë në Republikën e Shqipërisë, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ushtron aktivitetin e tij në një sipërfaqe prej 3860 m². Mësimi organizohet çdo ditë në tre fasha orare duke filluar nga ora 8:00 – 21:00, nga e hëna në të shtunë. Godina përmban aula në madhësi 100-120 vende në sipërfaqe 110metër katror, salla leksionesh e seminaresh, laboratorë etj. Sallat janë të pajisura me ndricim e aksesorë të duhur teknologjie për zhvillimin normal të aktivitetit përkatës, ndërkohë që rreth 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave është me dritare e ballkon me ajrosje e dritë.

Ambjentet e institucionit janë të përshtatshme për aktivitetin e mësimdhënies dhe aktivitetet ndihmëse. Laboratorët kompjuterike kanë kapacitet në me rreth 35 - 40 vende, bibliotekë me 4162 tituj librash, prej të

cilave rreth 1800 tituj në fushën e drejtësisë, me një hapësirë prej 104 dhe 107 metër katrorë dhe rreth 25- 30 vende leximi të hapur, përfshirë edhe jashtë sallës qendrore të bibliotekës (pjesë parahyrëse). Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike; gjithashtu katalogu elektronik është i mundur për studentët online për kërkim individual. Godina ka shërbim interneti 24 orë. Biblioteka Online e UMSH-së ka mbi 327,325 tituj librash. Gjatë vizitës në IAL, GVJ verifikoi ambientet e bibliotekës e cila ofron tituj të ndryshëm të lidhur me programin e studimit si dhe vende leximi/studimi. Hapësirat janë të pajisura me ndricim alternativ në rast ndërprerje të energjisë elektrike; gjithashtu në cdo kat të godinës janë të instaluar pajisjet mbrojtëse kundër zjarrit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

| | | |
|---|-------|------------|
| Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit | Sasia | Sipërfaqja |
| Salla për leksione | 6 | 563.5 |
| Klasa për seminare | 15 | 598.1 |
| Salla për aktivitete promovuese | 1 | 104 |
| Laboratorë informatike | 3 | 144 |
| Salla internet | 1 | 52 |
| Salla për bibliotekë | 4 | 157 |
| Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 15 |
| Zyrë informacioni për studentët | 1 | 14 |
| Korridore/holle | 10 | 680 |
| Mjedise sportive | ----- | |
| Mjedise shërbimi për të tretë | ----- | |
| Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 2 | 102 |
| Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 1 | 430 |
| Nyje hidrosanitare për studentët | 53 | 203.4 |
| Norma m2/për student | 5.395 | |

| | | |
|---|-------|------------|
| Mjediset për stafin: | Sasia | Sipërfaqja |
| Zyra për Rektorat/Dekanin/zv dekanin/ kancelarin | 7 | 170.5 |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 3 | 48 |
| Zyra për departamentet/Qëndrat kërkimore-shkencore/Zyra ZKSK/Marrëdhëniet me jashtë | 8 | 262.6 |
| Zyra për personelin akademik | 2 | 52.6 |
| Zyrë për financën | 1 | 30 |
| Zyrë për Njësinë e SBC | 1 | 25.5 |
| Salla për mbledhje | 1 | 58 |
| Mjedis për stafin e shërbimit | 2 | 64 |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 5 | 25.8 |
| Arkiva | 2 | 50 |
| Norma m2/për person | 5.1 | |

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|-----------------------------|
| Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron. | |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p> | <p>Gjatë vizitës në IAL ekspertet vizituan ambiente të ndryshme si salla mbledhjesh/leksionesh, zyra, bibliotekën, si dhe ambiente të përbashkëta. IAL-ja në fjalë përmbush kërkesat në lidhje me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve; spikat në cilësinë e mjediseve, përshtatshmërisë së sallave të leksioneve, aksesit të lehtë të studentëve etj. Ka një vendndodhje të qëndrueshme që përfshin si mjedisin qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Gjithashtu rezultojnë se këto mjedise janë në dispozicion të institucionit me qera për një afat 10 vjeçar.</p> |
|---|--|

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p> | <p>Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës dhe nga takimi që zhvilloi me drejtuesin e kësaj biblioteke, GVJ u njoh me literaturën e disponueshme për këtë program studimi. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit në fjalë bibliotekën me ambiente leximi, kompjutera si dhe me titujt elektronike dhe jo-elektronike.. Në fushën e së drejtës publike rezultojnë rreth 200 materiale (libra, revista, artikuj shkencor, etj) si dhe një librari elektronike me 16,679 tituj, abonim në eëë.questia.com si dhe “The economist” me një fond të rëndësishëm, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në brenda të godinës së Universitetit dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studiuesit. Në Rregulloren e Organizimit të UMSH ne nenin 30 të saj, sanksionohet se Biblioteka është njësi ndihmëse e Institucionit. Kjo njësi ofron shërbim për të nxitur punën kërkimore shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët.</p> <p>Nga IAL ndiqet një procedurë vjetore e pasurimit të bibliotekës bazuar në kërkesat që bëhen në fillim të çdo viti nga ana e stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u vendos në dispozicion edhe një praktikë e pasurimit të bibliotekës, blerjet e bëra si edhe një listë me literaturën që gjendet në bibliotekë. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se IAL nuk dokumenton literaturën për çdo program studimi por e ka të individualizuar atë mbi bazë fakulteti. Megjithatë gjatë vizitës në institucion, por edhe analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se literatura që mbështet programin e studimit, ajo e deklaruar në kurrikulat e lëndëve, është pjesë e fondit të bibliotekës dhe plotësisht e aksesueshme.</p> <p>Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit të lidhura me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p> |
|--|---|

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> | <p>Nga vëzhgimi që gjatë vizitës në institucion GVJ realizoi se infrastruktura në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Godina ka laboratorë, salla studimi, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura dhe kërkimit shkencor.</p> |
| <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> | <p>Prezenca e vetratave garanton hapësirë të mjaftueshme drite në auditor. Të gjitha sallat janë të pajisura me sistem audioviziv komunikimi. Sallat e leksioneve janë të ndërtuara në formë amfiteatri.</p> |
| <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> | <p>Në të gjitha hapësirat e UMSH/së ka shërbim interneti të vauhdushëm, me 2 laboratorë PC për studentët, me rreth 60 PC.</p> |
| <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p> | |
| <p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> | |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH ofron infrastrukturë të qëndrueshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative në funksion të programit Msc “E Drejtë Publike”, duke mundur arrijtjen e objektivave. 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e universitetit e cila ofron database elektronikë por dhe një shumëllojshmëri titujsh leximi në sallën e leximit. Biblioteka dhe salla e studimit është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët, studiuesit dhe gjithë palët që kanë interes të drejtpërdrejtë. 3. Mjediset në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik kanë standardin e nevojshëm për realizimin e qëllimeve specifike që duhet të arrihen nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | |

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare


Pjesa përshkrimore

Sipas dokumentacionit të institucionit, burimet e të ardhurave janë kryesisht tarifat e studentëve në manësen 98% në vitin 2017-2018 dhe në vitin 2018-2019 të programit Master Shkencor, ndërkohë që respektivisht rreth 2% vitin e parë dhe vitin e dytë të programit Master Shkencor është siguruar nga aktivitetet tregtare (rreth 0,5%) dhe nga grante kërkimore-shkencore (rreth 1,5%). Të ardhurat nga grantet kërkimore-shkencore rezultojnë të jenë një risi në elementin e të ardhurave të Institucionit në krahasim me akreditimin e fundit të programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):


- Grantet për kërkim 1,5%
- Konsulencat, shërbimet nuk ka
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 98%
- Sponsorizimet- nuk ka




- Shërbime trainuese etj nuk ka
- Donacione aktivitetet siguruese, fondacione etj nuk ka
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0,5 %

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. | |
| <p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p> | <p>Sipas informacionit të siguruar në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar nga GVJ, intitucioni realizon çdo vit audit të jashtëm, nëpërmjet të cilit miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Gjithashtu institucioni realizon edhe auditim të brendshëm në lidhje me situatën financiare dhe kontrollin e përdorimit të burimeve, duke përpunuar një relacion të miratuar nga Bordi i Administrimit. Në referim të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë burimet kryesore të të ardhurave janë kontributet nga studentët. Duke u bazuar në rregullimet statutore, ky Bord verifikon raportet për realizimet e detyrimeve të përcaktuara në qëllimet e përcaktuara nga strategjia për zhvillimin e Institucionit. Sipas RVB drejtimit e shpenzimeve fokusohen në rritjen e cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimin e stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës që lidhet me kushtet e punës dhe mesimdhënien, si hapësirat e Institucionit, kushtet higjeno-sanitare, të ruajtjes fizike, përdorimit të dritës, kushtet e mesimdhënies dhe qëndrimit, sistemeve teknologjike për zhvillimit e aktiviteve mësimore dhe shkencore.</p> |
| Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> | <p>UMSH rezulton të jetë projekt i OJF-së Qendra Mesdheu, siç i është referuar edhe GVJ gjatë vizitës në Institucion. Ky element rezulton në përputhje me standartet ligjore të ligjit për arsimin e lartë.</p> <p>Institucioni realizon një auditim financiar çdo vit akademik. Nga ky auditim dalin të dhënat në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë në përputhje me rregullat dhe standartet.</p> <p>Në kushtet aktuale UMSH reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor. Sidoqoftë të ardhurat kryesore, në masën 98%, janë të lidhura me të ardhurat studentore.</p> |

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Nga dokumentacioni i paraqitur menaxhimi i burimeve financiare rezulton të jetë në përputhje me veprimtarinë e institucionit.
2. Auditimi financiar vjetor është një instrument i rëndësishëm të kuadrin e garantimit të përdorimit të të ardhurave, për përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
3. Institucioni siguron të ardhurat kryesore nga tarifat studentore, duke lidhur veprimtarinë e tij me numrin e studentëve. GVJ rekomandon rritjen e faktorëve të tjerë në të ardhurat institucionale që mund të sigurojnë më mirë vazhdimësinë e tij dhe diversifikojnë riskun.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**Pjesa përshkrimore**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është strukturë ndihmëse në UMSH në funksion të zbatimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe varet nga Rektori i UMSH, sipas përcaktimve të nenit 28 të Rregullores Organizative të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Sipas RVB, NJSBCZHK “ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit”. Kjo strukturë është e përbërë nga 7 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga secila prej njësive kryesore të Universitetit. Objektivat e punës së kësaj njësie lidhen me zbatimin e metodave të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së institucionit. Pjesa qendrore e vlerësimit të performancës akademike e profesionale bazohet në formularë tip të depozituar në dokumentacionin e vlerësimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Instrumentat e parashikuar nga Rregullorja dhe të përdorur përgjatë programit Msc “E Drejtë Publike” janë si më poshtë:

I. Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë - Për të planifikuar punën lidhur me kontrollin e cilësisë, gjatë vizitës në institucion, intervista e realizuar me GVB si edhe me drejtuesin e NJSBZHK, GVJ u informua se NJSBZHK harton kalendarin e kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore për çdo vit akademik. Sipas këtij kalendari, në bashkëpunim edhe me departamentet ushtrohet aktiviteti i monitorimit të procesit mësimor në tërësi.

II. Hartimi dhe plotësimi i Pyetësorit për Studentët - Pyetësori hartohet nga NJSBZHK dhe plotësohet në mënyrë anonime nga studentët; ai plotësohet në përfundim të çdo semestri, pra 2 herë në vit dhe pëmban jo vetëm pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, që lidhen me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore, për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë, etj.



III. Intervistat me studentët - Intervistat apo takimet jo formale me studentët në formën e fokus grupeve, zhvillohen me qëllim që të diskutohet për procesin mësimor në përgjithësi dhe për probleme të veçanta që ata hasin përgjatë procesit mësimor.

IV. Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit – Drejtuesi i njësive bazë në periudha periodike kontrollon procesin e mësimdhënies së pedagogëve nëpërmjet shkëmbimit interaktiv.

Njësia në bazë të pyetësorëve dhe anketimeve përgatit raporte të ndryshme dhe ia paraqet ato autoriteteve drejtuese. Të dhënat e raporteve janë një nga elementët për vlerësimin e stafit akademik. Pedagogët njihen individualisht me këto të dhëna.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|--|
| Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. | <p>Institucioni realizon nevojat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë së brendshme nëpërmjet Njësië së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, e drejtuar në mënyrë profesionale nga njohës të proceseve të tilla.</p> <p>IAL përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit në fjalë. Këtu mund të përmendim metoda të tërthorta si vlerësimi i pedagogëve nga studentët dhe nga eprorët; marrja e mendimit nga “fokus grupet” me studentët për çdo semestër (siç rezultojn nga RVB dhe bisedave në IAL); vlerësimi i provimeve si dhe vlerësimi i syllabus-eve. - Të dhënat i vihen në dispozicion autoriteteve drejtuese dhe janë objekt analize në nivle departamenti dhe Fakulteti.</p> <p>Sipas karakterit të informacionit, vlerësohet edhe mundësia e publikimit të tyre.</p> <p>Nga vizita në institucion duke konsultuar në vend formularët përkatës dhe raportet e përpiluara nga personat përgjegjës, përfshirë dokumentacionin e praktikës, rezultojn se Njësia e mat ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi. Pjesë e vlerësimit rezultojn të jetë edhe aspekti i punës ndihmëse mbështetëse pranë njësive bazë për qëllime të përmbushjes së objektivave të procesit akademik, etj.</p> <p>Rezultatet janë të aksesueshme nga palët e interesuara siç u afirmua nga intervistat në Institucion.</p> |
| Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> | <p>Nga kontrolli, që realizoi vetë GVJ, nuk rezultojn që raportet e vlerësimit të brendshëm të realizuar nga vetë institucioni të publikohen në faqen e vetë të internetit</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p> | <p>Institucioni përpunon një raport mbi vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar në formën e broshurave promovuese të programeve dhe cilësisë që ato ofrojnë.</p> |
| <p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> | <p>Nga takimet në institucion rezulton se gjetjet e NJSBCZHK institucioni i zhvillon në formën e diskutimeve në nivel Senati, Fakulteti dhe Departamenti. Në këto nivele diskutohet me tej për dobesitë e konstatuara dhe për ecurinë e programeve, si edhe për përmirësimin e tyre. Në bazë të rezultateve të këtij procesi adoptohen edhe vendimmarrje në lidhje me ndryshime apo zhvillime të rëndësishme në fushën akademike e shkencore që synojnë përmirësimin e programit të studimeve të ciklit të dytë.</p> |
| <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p> | <p>Institucioni është licencuar në vitin 2009 dhe në vitin 2012 nëpërmjet Urdhërave 124/2012 dhe 291/2012 të Ministrisë të Arsimit është akredituar institucionalisht. Riakreditimi i fundit ka ndodhur në vitin 2017.</p> <p>NJSBCZHK drejtohet në mënyrë profesionale nga njohës të proceseve të matjes së performancës, në mënyrë efikase.</p> <p>Nga takimet në Institucion evidentohet se Institucioni organizon vlerësimin periodik brenda njësive me qëllimin e ruajtjes dhe rritjes së standardeve ligjore. Departamenti, Fakulteti dhe Rektorati vlerësojnë procesin e mësimdhënies nëpërmjet instrumentave si pyetësorë për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët të nivelit të njësive por edhe Fakultetit apo rektoratit, vlerësues për praktikën, etj. Nga komunikimi me personelin akademik dhe studentët mund të thuhet se informacioni mbi nevojën e matjes së performancës dhe cilësisë zotërohet qartë nga studentët dhe personeli akademik. Kjo tregon një angazhim në rritje nga ana e Institucionit për të përvetësuar proceset e garantimit të cilësisë në kuadrin e praktikës së punës. Strategjisë e institucionit thekson spektret e garantimit të cilësisë. Ky dokument është i aksesueshëm publikisht.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> | |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Njësië së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, në përbërjen e saj dhe në aktivitetin e saj, përmbush standartet për vlerësimin të sigurimit të cilësisë së brendshme. 2. Njësia mat ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese të tilla si: pyetësorë për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët të nivelit të njësive por edhe Fakultetit apo rektoratit, vlerësues për praktikën, etj. 3. Metodologjia e vlerësimit, instrumentat matëse dhe vlerësuese janë të shpjeguara në Raportin e | |




Vetëvlerësimet që bën Njësia për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe gjithashtu objekt i shqyrtimit dhe adresimit të detyrave përkatëse nga ana e autoriteteve drejtuese brenda Institucionit.

4. Institucioni nuk cakton ekspertë të jashtëm për verifikimin e gjendjes së punës. Analiza e një eksperti të jashtëm do të mundëonte rekomandime të mëtejshme për metodologjinë e mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, përmirësimin e tyre, përshtatjen e metodave të reja në gërshetim me teknikat/metodat tradicionale, dhe çdo komponent tjetër në funksion të rritjes së cilësisë dhe shkëmbim të praktikave të mira.
5. GVJ rekomandon një transparencë më të madhe në lidhje me të gjitha proceset e brendshme të zhvillimit të institucionit, sidomos në kuadrin e publikimeve on-line të raporteve.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Duke iu referuar objektivit të programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtën Publike” dhe Rregullores së këtij programi, konstatohet që programi në fjalë synon të realizojë formimin profesional të studentëve në fushën e së drejtës publike, t’i njohë ata me arritjet më të reja në këtë fushë si dhe të aftësojë studentët për të kryer kërkim shkencor në fushën e së drejtës publike. Gjithashtu, programi ka për objektiv të mundësojë aftësimin profesional të studentëve dhe specializimin e tyre në fushat e së drejtës kushtetuese, administrative, penale, ndërkombëtare dhe evropiane, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Vihet re se objektivat nuk përqendrohen vetëm në faktin e punësimit të studentëve, por dhe të krijimit të bazave për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në Shkollën e Magjistraturës, të Avokatisë, etj. Programi, për arritjen e këtyre objektivave, u mundëson studentëve mjetet themelore të nevojshme për thellimin e dijeve dhe zhvillimin e aftësive, krijon hapësira për të shtrirë studimin jo vetëm në nivelin teorik, por dhe atë praktik, si dhe krijon lehtësira të mjaftueshme për të nxitur punën kërkimore shkencore në fushën e së drejtës publike, falë literaturës, e cila është e aksesueshme në mënyra të ndryshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit “Master i Shkencave” në fushën e të Drejtës Publike është hapur në vijim të urdhrimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 346, datë 17/09/2015 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në të Drejtë Publike”, në institucionin “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, sot UMSH. Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2015-2016.

Programi në fjalë ka për qëllim:

- Promovimin e studimit dhe kërkimit shkencor në fushën e së drejtës publike, sidomos në kuadër të së drejtës kushtetuese, administrative, ndërkombëtare, të BE-së, etj., por dhe trajtimin e këtyre degëve të së drejtës në këndvështrimin krahasimor e të thelluar, në harmoni me zhvillimet aktuale shkencore;
- Formimin e specialistëve në fushat e së drejtës të përmendura në paragrafin më lart;
- Përmirësimin e nivelit të programeve, shkëmbimin e përvojës dhe kërkimit shkencor.

Programi ka si objektiv:

- Formimin dhe aftësimin profesional të studentëve, me qëllim punësimin e tyre sipas kërkesave të tregut të punës (në administratën publike, sistemin bankar, shoqëritë tregtare, sistemin e avokatisë, etj.) si dhe vijimin e studimeve në Shkollën e Magjistraturës apo Shkollën Kombëtare të Avokatisë;



- Përvetësimin e kulturës ligjore bazë, të brendshme dhe ndërkombëtare (sidomos evropiane) si dhe pajisjen me mjetet themelore të nevojshme për të përditësuar aftësitë e studentëve;
- Zhvillimin civil dhe kulturor, sensin e lartë të etikës, respektimin e ligjit, duke i dhënë rëndësi edhe lirisë së sjelljes e të mendimit, zhvillimit të konkurrencës, etj.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit është i organizuar në dy vite mësimore, të përbërë nga katër semestra me 120 ECTS gjithsej. Organizimi i programit mësimor realizohet në auditor (leksione dhe seminare) dhe jashtë auditorit. Sa u përket orëve mësimore në auditor, janë parashikuar gjithsej 480 orë leksione dhe 970 orë punë e pavarur e studentëve, ndërsa sa u përket seminareve, janë parashikuar 360 orë mësimore seminare në auditor dhe 440 orë punë e pavarur e studentëve.

Në përfundim të programit, studentëve u jepet diploma e emërtuar “Master i Shkencave në të Drejtë Publike”.

Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Publike” paraqitet si më poshtë:

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore pune të studentit
- 1 orë mësimore 60’ (Kohëzgjatja e seancave mësimore prej 60’, referuar në RVB, vjen në kundërshtim me rregullimet e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe me nenin 19 të Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Publike të UMSH).

Referuar Raportit të Vlerësimit të muajit Maj 2017, lidhur me javët mësimore për vitin akademik, është evidentuar se në RVB është shënuar 45 orë, por nuk rezulton nga plani mësimor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të siguruar nga UMSH dhe vizita në institucion, u konstatua se kjo mospërputhje është korrigjuar.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë Në programin e studimit janë përfshirë gjithsej 14 (katërmëdhjetë) lëndë, të cilat ndahen në lëndë të formimit të përgjithshëm (12 ECTS), lëndë të formimit karakterizues të programit (62 ECTS), lëndët ndërdisiplinore dhe/ose integruese dhe lëndët me zgjedhje (16 ECTS), lëndët plotësuese (16 ECTS) dhe teza e diplomës (18 ECTS).

Plani mësimor është ndarë sipas veprimtarive A, B, C, D, E.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:



- | | | |
|------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|
| ▪ Për leksionet | 8 orë në auditor dhe | 17 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 11 orë në auditor dhe | 14 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 20 orë në auditor dhe | 5 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Teza e diplomës | 2 orë në auditor dhe | 23 orë punë e pavarur e studentit |

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara

Nuk ka ndryshime në planin mësimor.

Planet mësimore janë të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i angazhuar në hartimin e planeve mësimore është i përbërë kryesisht nga personel i punësuar me kohë të plotë në programet e ciklit të dytë Master në të Drejtë Publike. Referuar kriterëve që përcakton ligji Nr. 80/2015, për vitin akademik 2017-2018, 7 nga 12 titullarët e lëndëve mbajnë titullin Prof.Dr/Prof.Asoc.Dr., kundrejt 5 titullarëve me gradën shkencore Dr. Për vitin akademik 2018-2019, 5 nga 12 titullarët e lëndëve mbajnë titullin Prof.Dr/Prof.Asoc.Dr., kundrejt 7 titullarëve me gradën shkencore PhD/Dr.

Referuar programit të lëndëve dhe dosjeve të pedagogëve, RVJ konstaton se secili anëtar i personelit akademik është përzgjedhur për secilën lëndë, në përputhje me fushën e tij të specializimit.

Për çdo lëndë janë hartuar Syllabus-et përkatës, ku pasqyrohet emërtimi i lëndës, viti dhe semestri i zhvillimit të lëndës, emri i pedagogut/grupit të pedagogëve, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës, njohuritë dhe aftësitë që i siguron lënda studentit, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies së lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, literatura e detyrueshme dhe ndihmëse.

Analizë e cilësisë së syllabus-eve

Vlen të evidentohet fakti që syllabus-et kanë përgjithësisht të njëjtën formë, ndryshojnë në pikëpamje të përbajtjes, në varësi të lëndës dhe specifikave të këtyre të fundit. Syllabus-et janë ndërtuar në mënyrë të detajuar, duke paraqitur në pjesën e parë të tyre titullin e lëndës, titullarin, ngarkesën në kredite, përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje, vitin akademik dhe semestrin në të cilin do të zhvillohet. Syllabus-et sqarojnë objektivat e lëndës, referuar përbajtjes së saj, format dhe metodat e mësimdhënies, konceptet themelore dhe tematikat e leksioneve, duke përcaktuar dhe literaturën e kërkuar. Syllabus-i hartohet nga titullari i lëndës e mandej shyrtohet dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Mund të thuhet se syllabus-et në përgjithësi synojnë ezaurimin e plotë të lëndës, në përputhje me objektivat e vendosur. Temat e planifikuara përputhen me emërtimin e lëndës, që është përfshirë në programin e studimit. Duke krahasuar syllabus-et për secilin nga dy vitet akademikë, objekt vlerësimi, konstatohet që kanë pësuar ndryshime dhe janë përmirësuar e përditësuar në përputhje edhe me zhvillimet e reja ligjore në Shqipëri e më gjerë.

Nga shqyrtimi në tërësi i syllabus-eve, nuk konstatohet mbivendosje e lëndëve.

Duhet theksuar dhe evidentuar fakti se, në pikëpamje të modelit, syllabus-et nuk janë përditësuar nga secili pedagog në përputhje me elementet sipas modelit që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në lidhje me pikën 2.8 të këtij akti. Gjithashtu, ka dhe syllabus-e që përcaktojnë shprehimisht frekuentimin e detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve nga ana e studentëve (në përqindje).


Nga vizita në IAL u konstatua se në pjesën dërrmuese të lëndëve, literatura e përdorur përfshin punimet e autorëve më të njohur në degët e së drejtës publike, vendas por dhe të huaj, dhe në rastet e disiplinave pak të trajtuara në Shqipëri përdoren leksione të punuara nga lektorët e lëndës, të cilët u shpërndahen studentëve në bibliotekën e universitetit përmes shumëfishimit.

Lidhur me literaturën, duke iu përmbajtur të dhënave të siguruara nga IAL, pjesa dërrmuese e literaturës i përket pesë viteve të fundit, por hasen dhe raste në të cilët literatura bazë, e detyruar, nuk është e përditësuar, ndaj do të ishte i këshillueshëm ky përditësim, për të sjellë para studentëve përveç parimeve bazë dhe njohuritë më të fundit në fushën specifike të së drejtës, objekt studimi në programin Master i Shkencave në të Drejtën Publike.

Konstatohet njehsimi i formës së vlerësimit për të gjitha lëndët, ndarë në përqindje: frekuentimi i leksioneve/seminareve 10%, detyra kursi/ese/provime të ndërmjetme 30%, provimi përfundimtar 60%. Gjithsesi, kjo formë vlerësimi nuk pasqyrohet në secilin nga syllabus-et e vëna në dispozicion nga institucioni, që i përkasin vitit akademik 2018-2019.


Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Lidhur me këtë standard, nga institucioni janë vënë në dispozicion planet mësimore, syllabus-et, vëzhgim i tregut të punës, aktet e brendshme të funksionimit të institucionit, RVB, etj.



Vlerësimi sipas Standardeve


| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|---|
| Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p> | <p>Programi “Master Shkencor në të Drejtë Publike” është akredituar me vendimin Nr. 38, datë 19/07/2017 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është data 31/07/2019. Aktualisht, ky program është në proces të akreditimit periodik. Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, në pajtim me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin me kohë të plotë është 60 kredite. Konsatohet se në përputhje me rekomandimin e lënë nga akreditimi për herë të parë, është plotësuar ndarja e barabartë e krediteve në të dy vitet.</p> |
| Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | |
| <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> | <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në të Drejtën Publike” u siguron studentëve që e ndjekin, dije të thelluara në lëmin e të drejtës publike, në aspektin teorik e praktik, në të gjitha fushat e kësaj të drejte, njohuritë bazë të cilave sigurohen në programin bachelor në drejtësi. Programi synon dhe aplikon bashkëpunimin me institucione homologe vendase dhe të huaja për qëllime të mësimdhënies si dhe bashkëpunimin me ente e institucione që veprojnë në sektorin publik, privat dhe të shoqërisë civile, për qëllime të praktikës dhe integritimit në tregun e punës.</p> <p>Njohuritë që ofron programi u lehtësojnë studentëve aftësinë e të shkruarit, komunikimit dhe punës në grup si dhe krijojnë një gamë të gjerë mundësish për punësim në sektorë të ndryshëm. Këto njohuri pasojnë ato të fituara gjatë ciklit të parë të studimeve, dhe përparojnë më tej gjatë programit Master.</p> <p>Dijet e thelluara që ofron programi krijojnë baza të mira për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në programet që ofrojnë Shkolla e Magjistraturës dhe Shkolla Kombëtare e Avokatisë; gjithashtu, ky program mundëson dhe avancimin drejt programeve të studimit të doktoraturës, në fushën akademike e të kërkimit shkencor.</p> |





| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> | |
| <p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p> | <p>Objektivat e programit të studimeve, sa i përket përmbajtjes dhe renditjes së tyre, pajtohen më së miri me Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Programi Master i Shkencave në të Drejtë Publike si dhe me Planin Strategjik të UMSH. Objektivat kanë për synim plotësimin me efikasitet të qëllimeve, në përputhje dhe me nivelin e studimeve.</p> <p>Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve, rezultojnë nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion, kontaktet dhe bisedat e zhvilluara me personelin akademik e përfaqësinë studentore, përdorimi i metodave të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet nëpër syllabus-e, metodatat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kurse, kazuse, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare me gojë e shkrim.</p> |
| <p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> | <p>Në përputhje me aktet e brendshme strategjike, programi Master i Shkencave në të Drejtë Publike është përpjekur të ndjekë përvojat e universiteteve evropiane, gjë që është reflektuar në përmbajtjen e programit dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta.</p> <p>Nga shqyrtimi i akteve të vënë në dispozicion nga institucioni konstatohet se syllabus-et, nga ana formale, nuk janë përditësuar nga të gjithë pedagogët sipas modelit që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Gjithashtu, disa prej tyre nuk përmbajnë të dhëna lidhur me frekuencimin e detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve nga ana e studentëve (në përqindje).</p> <p>Programi synon gjithashtu që t’u lehtësojë studentëve aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë.</p> <p>Sipas rekomandimeve të lëna nga akreditimi për herë të parë, nga dokumentacioni dhe takimet me stafin pedagogjik, rezultojnë se programi përfshin më pak lëndë në fushën e të drejtës penale. Pra, janë shtuar lëndët që studiojnë kryesisht të drejtën publike, të drejtën e Bashkimit Evropian, të drejtat e njeriut.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në të Drejtë Publike, është ndërtuar në mënyrën e duhur sa i përket planit mësimor, krediteve, kushteve të pranimit, metodave të vlerësimit.</p> |
| <p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> | <p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit si dhe i dokumentacionit në tërësi, vërehet se programi Master i Shkencave në të Drejtë Publike përfshin si studimet e thelluara teorike, por dhe kërkimin shkencor. Programi</p> |

Abel Mendonça

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p> | <p>thekson lëndët e të drejtës kushtetuese, administrative, të drejtat e njeriut, të drejtën komunitare, që përputhen plotësisht me objektivat e studimit dhe specializimin në të drejtën publike si dhe me mundësinë për punësim në organe të administratës publike e më tej.</p> <p>Programi është në harmoni me profilin e IAL dhe me objektivat e tij, të shprehur në planet strategjike të brendshme. Kurrikula e programit është përmirësuar, në përputhje me rregulloren e tij dhe rekomandimet e BA, duke ofruar edukim të thelluar në lëndë të së drejtës publike.</p> <p>Sipas akteve të administruar nga IAL si dhe bisedat e zhvilluara me personelin akademik, ky i fundit është përfshirë gjerësisht në punën kërkimore shkencore, me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Vetë UMSH përpiqet të lehtësojë pedagogët në punën kërkimore nëpërmjet mbështetjes financiare dhe infrastrukture.</p> |
| <p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | <p>Rezultoni se nga ana e UMSH është realizuar analiza e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e programeve bachelor dhe master. Në këtë analizë janë marrë në shqyrtim karakteristikat e nevojave të tregut si dhe është bërë analiza e ofertës, duke shfrytëzuar të dhëna nga Instat, ILO dhe burime të tjera. Analiza në fjalë përfshin dhe programin Master i Shkencave në të Drejtën Publike, duke iu referuar dhe programeve të ngjashme universitare që ofrohen në universitetet shtetërore dhe në SHLP private shqiptare, të akredituara. Analiza e tregut të punës merr në shqyrtim mundësitë për punësim dhe nevojat e tregut në fushën e së drejtës publike, në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Sikundër u evidentua më lart, UMSH ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, në përshtatje me programin e studimit Master i Shkencave në të Drejtën Publike. Përshtatja me këto nevoja reflektohet dhe në strategjinë e zhvillimit të programit duke përcaktuar zbatimin e dy projekteve studimore nga ana e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Arritja e këtij synimi u shpreh dhe në takimin e kryer me stafin e UMSH në institucion.</p> <p>U konstatua, gjithashtu, nga takimi me studentët se pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar dhe programi që ndjekin në të drejtën publike u vlen jo vetëm në vendin e punës, por dhe në gjetjen e mundësive të reja për punësim dhe ndjekje studimesh të mëtejshme.</p> <p>Gjithsesi, analiza e tregut të punës përdor një metodikë të tërthortë, duke përfshirë të gjitha llojet e profesioneve që formohen në UMSH.</p> |
| <p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p> | |




| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> | <p>Programi i studimit nuk cenon dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore kombëtare, edhe pse nuk mund të vlerësohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> |
| <p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p> | <p>Programi i studimeve Master i Shkencave realizohet me 120 kredite evropiane ECTS. Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike. Për praktikën profesionale janë përcaktuar 12 kredite dhe për diplomën 18 kredite. Programi respekton parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Ndarja e krediteve sipas viteve është 60 me 60. Në këtë kuptim, institucioni ka plotësuar rekomandimin për ndarjen e barabartë të krediteve në të dy vitet akademike, duke mos krijuar më tepër ngarkesë në vitin e dytë akademik.</p> |
| <p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p> | <p>Studentët kanë mundësi të njihen me përmbajtjen e programit përmes informacioneve që u sigurohen nëpërmjet përkatëse. Konkretisht, të dhënat që u sigurohen përqendrohen tek përmbajtja e programit të studimit, syllabus-et, praktika mësimore si dhe tek rregullorja për frekuentimin e lëndës. Për këtë qëllim, veç formave elektronike, institucioni përdor dhe broshura të shtypura, që përmbajnë programin e studimit. Studentët janë shpehur gjatë takimit se marrin në mënyrë të detajuar të dhëna mbi programin. Nga takimi me pedagogët, këta të fundit konfirmuan se i njohin studentët me përmbajtjen e syllabus-it që në fillim të studimit të lëndës.</p> |
| <p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> | <p>Struktura e planit të diplomimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që diplomimi të realizohet brenda afateve të parashikuara prej 2 vite akademike. Mënyra e diplomimit paraqitet e detajuar në udhëzimin për punimin e diplomës dhe kalendarin e diplomës, të cilët u njoftohen pedagogëve dhe studentëve në një afat të arsyeshëm kohor me qëllim marrjen e masave për përgatitjen e saj. Për praktikën profesionale janë përcaktuar 12 kredite dhe</p> |





| | |
|--|--|
| Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | për diplomën janë përcaktuar 18 kredite. |
| <u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit “Master i Shkencave në të Drejtën Publike”, i ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, u siguron studentëve që e ndjekin, dije të thelluara në lëmin e të drejtës publike, në aspektin teorik e praktik, në të gjitha fushat e kësaj të drejte, njohuritë bazë të të cilave sigurohen në programin Bachelor në drejtësi. 2. Objektivat e programit të studimeve, sa i përket përmbajtjes dhe renditjes së tyre, pajtohen më së miri me Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Programi Master i Shkencave në të Drejtë Publike si dhe me Planin Strategjik të UMSH. 3. Programi mundëson aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë, në programet që ofrojnë Shkolla e Magjistraturës dhe Shkolla Kombëtare e Avokatisë; gjithashtu, ky program aspiron dhe avancimin drejt programeve të studimit të doktoraturës, në fushën akademike e të kërkimit shkencor. 4. Sipas rekomandimeve të lëna nga akreditimi për herë të parë, nga dokumentacioni dhe takimet me stafin pedagogjik, rezulton se programi përfshin më pak lëndë në fushën e të drejtës penale dhe thekson lëndët e të drejtës kushtetuese, administrative, të drejtat e njeriut, të drejtën komunitare, që përputhen plotësisht me objektivat e studimit dhe specializimin në të drejtën publike si dhe me mundësinë për punësim në organe të administratës publike e më tej. 5. Programi respekton parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Ndarja e krediteve sipas viteve është 60 me 60. Në këtë kuptim, institucioni ka plotësuar rekomandimin për ndarjen e barabartë të krediteve në të dy vitet akademike, duke mos krijuar më tepër ngarkesë në vitin e dytë akademik. 6. Rekomandohet që, sa i përket anës formale (modelit), syllabus-et të përditësohen nga të gjithë pedagogët e programit Master i Shkencave në të Drejtë Publike, sipas modelit që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. | |

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia, në përputhje me rregullat e përcaktuara në programin e studimit Master i Shkencave në të Drejtën Publike, realizohet përmes leksioneve, seminareve, praktikës profesionale dhe orëve të konsultimit. Nga bisedat e zhvilluara me studentët dhe stafin e pedagogëve, vërehet se në metodologjinë e përdorur për mësimdhënie zbatohet edhe zhvillimi interaktiv i leksioneve për një efektivitet më të lartë në të kuptuar e nxënë. Seminarat zhvillohen në formën e debatit dhe kontrollit të dijeve nga lektorët, të cilët bëjnë vlerësimin e përgjithshëm dhe individual të dijeve të fituara, formë e cila ndikon në vlerësimin përfundimtar të studentëve, por dhe për trajtimin më të hollësishëm të çështjeve që nuk janë përthithur plotësisht. Përveç formave klasike të mësimdhënies, përdoren dhe forma të tjera, nëpërmjet mjeteve teknologjike, diskutimet për raste praktike, puna në grup, metoda *brainstorm*, si dhe organizimi i auditoreve të hapura me specialistë në fushat që përputhen me programin e studimit. Prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme në masën 75%. Studenti ka të drejtë të futet në provimin e lëndës, pasi të ketë shlyer detyrimet akademike që lidhen me të, të parashikuara në planin mësimor dhe programin e lëndës. Vlerësimi i dijeve është me notë, sipas sistemit prej dhjetë notash, duke iu referuar pikëve të marra sipas parashikimit në syllabus-in e lëndës. Tezat e provimeve të lëndëve, pavarësisht formës së kontrollit, hartohen nga titullarët e lëndës dhe miratohen e nënshkruhen nga Koordinator i Programeve Master (në mungesë të tij nga përgjegjësi i departamentit, përgjegjës për programin).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies rezulton si në vijim:

| | |
|-------------------------|-----------|
| • Leksione | 480 orë |
| • Seminare | 360 orë |
| • Praktikë profesionale | 240 orë |
| • Totali | 1080 orë. |

- Format e kontrollit të njohurive

Sa i përket formave të kontrollit të njohurive të fituara, vlerësimi me notë bëhet mbi bazën e:

| | |
|--|-------|
| Ndjekjes së lëndës dhe pjesëmarrjes aktive | 10% |
| Testimeve gjatë vitit | 30% |
| Provimit përfundimtar | 60% |
| Total | 100%. |

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Referuar të dhënave të administruara rezulton se numri i studentëve të angazhuar në aktivitetet shkencore të UMSH gjatë periudhës Shtator 2016 – Mars 2019 paraqitet si më poshtë:

| | |
|---|----|
| Për punime shkencore individuale të pedagogëve | 94 |
| Për projekte shkencore në rang departamenti | 12 |
| Për projekte shkencore në rang fakulteti | 30 |
| Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë | 62 |

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Lidhur me këtë standard, nga institucioni u vunë në dispozicion aktet e brendshme të funksionimit të tij, planet mësimore dhe syllabus-et, përmbledhjet e punës shkencore, formatet e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, agjenda e aktiviteteve me studentë dhe pedagogë, kalendari akademik, lista e pedagogëve udhëheqës, praktikat, korrespondencë me QSHA, format i librit të Alumnit, formulari i tutoriatit, info Klinika Ligjore, plan veprimi i ZKSK, urdhër për student me aftësi të kufizuara, pyetësori i studentit, proces vlerësimi stafit akademik UMSH, udhëzues mbi autoritetin e tutoriatit, mesataret në dalje, RVB, etj.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Referuar kriterëve që përmban Rregullorja e programit, pranimi i studentëve që ndjekin Masterin e Shkencave në të Drejtë Publike është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 9741, datë 21/05/2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UMSH dhe Rregullorja e programit. Konkretisht, pranohen për ndjekjen e programit studentët që zotërojnë minimalisht diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Sipas nenit 12 të Rregullores së programit, në Masterin e Shkencave në të Drejtë Publike mund të pranohen pa

plotësim kreditesh: (1) studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkencë juridike pranë UMSH; (2) studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në E drejtë publike apo profile të ngjashme në universitete të tjera brenda dhe jashtë shtetit; (3) studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në fusha të tjera apo profile të ngjashme në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Pranimi i tyre bëhet në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave, duke iu nënshtruar fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përfshihet dhe përcaktimi i debiteve formuese që duhet të plotësojë studenti para hyrjes në programin e studimit.

Kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve përcaktohen nga universiteti në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Përzgjedhja e kandidatëve vijon pas procedurës së shpalljes, nga një komision i caktuar nga dekani, bazuar në dokumentacionin e përfshirë në dosjen personale të kandidatit.

Numri i të pranuarve në program gjatë vitit akademik 2017-2018 është gjithsej 107 dhe gjatë vitit akademik 2018-2019 është gjithsej 107. Në Rregulloren e programit, në asnjë prej dispozitave të tij, nuk është parashikuar numri maksimal i të pranuarve që do të ndjekin këtë program, duke plotësuar në këtë kuptim rekomandimin e lënë nga eksperti i jashtëm në procedurën e akreditimit për herë të parë të këtij programi.

Koha mesatare e zgjatjes së programit të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Publike nuk është më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pra 2 vite akademike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore, në institucion, u konstatua se në regjistrin e miratuar nga Ministria e Arsimit janë pasqyruar në mënyrë të rregullt të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike, sa i përket numrit të matrikullimit, datës së diplomimit, dokumenteve të transferimit për studentë që kanë transferuar studimet, njohjen e krediteve pas transferimit. Institucioni ka bërë gjithë përpjekjet e nevojshme për të rregulluar këtë mangësi të konstatuar gjatë procedurës së akreditimit të parë dhe ka pasur komunikim të vazhdueshëm shkresor me Ministrinë e Arsimit lidhur me problematikat në këtë drejtim (shih shkresën Nr. 763 Prot., datë 24/04/2019 drejtuar QSHA). Të dhënat në regjistër janë në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, gjë e cila rezultoi pas kontrollit të tyre, sipas një përzgjedhjeje të rastësishme. Duhet evidentuar se në regjistër, edhe pse gjendet një kolonë e veçantë për të pasqyruar gjuhën e huaj që zotëron studentit dhe nivelin përkatës, të dhënat për këtë rubrikë ishin të paplotësuara, edhe pse në dosjen personale të regjistrimit të studentit gjendej çertifikata/dëshmia e njohjes së gjuhës.

Gjatë vazhimit të studimit dhe pas përfundimit të tyre, studentët kanë mundësinë të krijojnë kontakte dhe shkëmbejnë informacione me ZKSK, e cila ka marrë përsipër të mbledhë të dhëna lidhur me punësimin e tyre dhe më pas të përpunojë statistikën për çdo program studimi. Gjatë kohës së studimeve, ZKSK ofron informacione për kryerjen e studimeve të doktoraturës, projekte të ndryshme studimore dhe pjesëmarrjen në programe vendase e të huaja.

Institucioni ndjek politika favorizuese në drejtim të punësimit të studentëve që kanë ndjekur programet e ofruar prej tij dhe kanë mbaruar studimet me rezultate të larta.

Gjithashtu, institucioni, vërtetuar nga vizita në të dhe dokumentacioni i administruar, tregon kujdes të posaçëm për studentët me aftësi ndryshe, në drejtim të përshtatjes së ambienteve fizike me nevojat e tyre, por dhe të zhvillimit të procesit të mësimdhënies e të shlyerjes së detyrimeve vjetore (provimeve). Mbështetje nga ana e institucionit, lehtësira nga pikëpamja financiare, është treguar dhe për studentët që nuk zotërojnë mjetet e nevojshme ekonomike.

Nga takimi me studentët, kërkesa e tyre kishte të bënte me shtimin e ambienteve sportive.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve janë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe janë detajuar në statutin e UMSH, Rregulloren e organizimit të universitetit dhe në udhëzimet e nxjerrë nga Rektori për çdo vit akademik.

Kandidati fiton statusin e studentit kur plotëson në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtëm:

1. Është regjistruar në sekretarinë mësimore sipas procedurës përkatëse;
2. Ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm;
3. Ka paguar tarifën e regjistrimit;
4. Ka nënshkruar kontratën e studimit.

Ky status përfundon me diplomimin e studentit apo me përjashtimin nga UMSH për arsye objektive.

Sa i përket kushteve specifike, janë përcaktuar:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloren e programit të studimit;
2. Pranimi bëhet sipas specifikave të programit të bazuar në rregulloren e tij, nevojat e tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukurore të institucionit;
3. Njohja nga kandidati e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Evropian.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Nga të dhënat e administruara rezulton se gjatë dy viteve akademike të fundit, nota mesatare e studentëve të pranuar në program është 7.3 dhe 7.1. Nota mesatare e studentëve të diplomuar për të dy vitet është 8.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare:

Për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë të regjistruar në vitin e parë 105 studentë, nga të cilët 36 femra dhe 69 meshkuj – nota mesatare në hyrje 7.3.

Për vitin akademik 2018-2019 rezultojnë të regjistruar në vitin e parë 106 studentë, nga të cilët 45 femra dhe 61 meshkuj – nota mesatare në hyrje 7.1.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).

Studentë të diplomuar për vitin akademik 2016-2017 janë 36.

Studentë të diplomuar për vitin akademik 2017-2018 janë 47.

Nota Mesatare - 8 - .

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

UMSH njihet kreditet e përfituara dhe transferon studimet midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion dhe institucioneve të tjerë. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimesh dhe në fusha të njëjta studimi apo të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe për transferimin e studentëve janë parashikuar në rregulloren e institucionit.

Rezulton se për vitin akademik 2017-2018 janë gjithsej 2 studentë të transferuar, ndërsa për vitin akademik 2018-2019 është 1 student i transferuar.

Të dhëna për punësimin e studentëve

UMSH zotëron të dhëna për punësimin e studentëve në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me të.

Numri total të diplomuarve

Për vitin akademik 2016-2017 numri total i të diplomuarve është 36.

Për vitin akademik 2017-2018, numri total i të diplomuarve është 47.


Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Të punësuar në total, në përputhje me diplomën, për vitin akademik 2016-2017 janë 21 (58%).

Të punësuar në total, në përputhje me diplomën, për vitin akademik 2017-2018 janë 35 (74%).

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Të punësuar në total, jo në përputhje me diplomën, për vitin akademik 2016-2017 janë 11 (31%).



Të punësuar në total, jo në përputhje me diplomën, për vitin akademik 2017-2018 janë 12 (26%).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Lidhur me këtë standard, nga institucioni u vunë në dispozicion aktet e brendshme të funksionimit të tij, planet mësimore dhe syllabus-et, përmbledhjet e punës shkencore, formatet e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, agjenda e aktiviteteve me studentë dhe pedagogë, kalendari akademik, lista e pedagogëve udhëheqës, praktikat, korrespondencë me QSHA, format i librit të Alumnit, formulari i tutoriatit, info Klinika Ligjore, plan veprimi i ZKSK, urdhër për student me aftësi të kufizuara, pyetësi i studentit, proces vlerësimi stafit akademik UMSH, udhëzues mbi autoritetin e tutoriatit, mesataret në dalje, RVB, etj.



Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë. | |
| <p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të</p> | <p>Studentët që ndjekin programin e studimeve Master i Shkencave në të Drejtë Publike zotërojnë minimalisht diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Pranimi i studentëve që ndjekin Masterin e Shkencave në të Drejtë Publike është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UMSH dhe Rregullorja e programit.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve përcaktohen nga universiteti në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Përzgjedhja e kandidatëve vijon pas procedurës së shpalljes, nga një komision i caktuar nga dekani, bazuar në dokumentacionin e përfshirë në dosjen personale të kandidatit.</p> <p>Njohja e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Evropian, kundrejt dorëzimit të çertifikatës së njohjes, është një ndër kriteret e pranimit të kandidatëve për student. Plotësimi i këtij kriteri rezultoi dhe nga kontrolli që iu bë dosjeve të studentëve, përzgjedhur në mënyrë rastësore gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Në regjistrin e miratuar nga Ministria e Arsimit janë pasqyruar në mënyrë të rregullt të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike, sa i përket numrit të matrikullimit, datës së diplomimit, dokumenteve të transferimit për studentë që kanë transferuar studimet, njohjen e krediteve pas transferimit. Të dhënat në regjister janë në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, gjë e cila rezultoi pas kontrollit të tyre, sipas një përzgjedhjeje të rastësishme. Duhet evidentuar</p> |




| | |
|--|--|
| <p>studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p> | <p>se në regjistër, edhe pse gjendet një kolonë e veçantë për të pasqyruar gjuhën e huaj që zotëron studenti dhe nivelin përkatës, të dhënat për këtë rubrikë ishin të paplotësuara, edhe pse në dosjen personale të regjistrimit të studentit gjendej çertifikata/dëshmia e njohjes së gjuhës. Institucioni përcakton kriteret e pranimit të studentëve në program në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me politikat e universitetit. Në varësi të këtij kuadri e nevojave institucionale, UMSH harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p> |
| <p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p> | <p>Informacioni dhe këshillimi për karrierën, u sigurohet studentëve nga Zyra përkatëse e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ZKSK. Informacioni u jepet kryesisht gjatë vitit të dytë të programit Master i Shkencave dhe në përfundim të programit, nga Dekani i Studentëve. Institucioni mban librin e studentëve të diplomuar (Alumni) me të dhënat specifike që lidhen me ta. Duhet evidentuar se nga takimi i zhvilluar me studentët në institucion, ata nuk e njihnin figurën e Dekanit të Studentëve dhe e perceptonin si dekanin e fakultetit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, rezultoi si nga aktet shkresore të konsultuara, por dhe nga bisedat me personelin akademik, atë administrativ e studentët, që këtyre të fundit në mënyrë të vazhdueshme u jepen të dhëna të vlefshme lidhur me akreditimin e institucionit, programet që ofrohen, njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës që jepet në përfundim të programit të studimeve. Këto informacione u sigurohen të interesuarve që në kontaktin e parë që kanë me sekretarinë e institucionit.</p> <p>ZKSK ofron informacione për kryerjen e studimeve të doktoraturës, projekte të ndryshme studimore dhe pjesëmarrjen në programe vendase e të huaja.</p> |
| <p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> | <p>Nga aktet e shqyrtuar në institucion dhe takimet e zhvilluara, institucioni zotëron të dhëna të sakta sa i përket numrit të studentëve të diplomuar sipas programeve që kanë ndjekur. Brezi i parë i studentëve është diplomuar gjatë vitit akademik 2016-2017.</p> <p>Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara. Të dhënat gjenden në sekretarinë mësimore dhe në zyrën e statistikave.</p> <p>Po ashtu, institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve që nga momenti i pranimit</p> |

| | |
|---|---|
| | e deri në diplomim. Evidentohet bashkëpunimi i përgjegjësit të njësisë bazë me sekretarinë mësimore, lidhur me këto të dhëna. |
| Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p> | <p>Rezulton se institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët edhe pas diplomimit të tyre. Institucioni paraqet të dhëna lidhur me studentët e punësuar në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me të, ku mbizotëron numri i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën. Përmes aktiviteteve që zhvillon, institucioni synon të shndërrojë në pika kontakti entet dhe subjektet private, me qëllim nxitjen e punësimit të studentëve.</p> <p>Vlen të theksohet krijimi i Klinikës Ligjore “Mesdhetari”, një ndër qëllimet e të cilës është aftësimi praktik i studentëve të drejtësisë.</p> <p>Nga takimet në institucion u konstatua se institucioni ndjek politika favorizuese të punësimit për studentët me rezultate më të larta, që kanë ndjekur programet e ofruar prej tij.</p> <p>Institucioni mban të dhëna edhe për studentët që vazhdojnë studimet në ciklet e tjerë të studimeve, duke u përpjekur që të krijojë mundësi punësimi të tyre dhe brenda institucionit.</p> |
| Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p> | <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit informues dhe bisedave me studentët, mund të konfirmohet se këta të fundit marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni sigurohet dhe nëpërmjet faqes online të UMSH.</p> <p>Lidhur me rezultatet e vlerësimit, rol luan sistemi SMS, në të cilin studentët kanë akses me anë të llogarisë vetjake.</p> <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion rezultoi se, pasi njihet me vlerësimin (notën), lektori cakton seanca sqaruese me studentët. Në përfundim të tyre, notat hidhen në sistemin elektronik nga pedagogu.</p> |
| Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> | <p>Institucioni ka ngritur strukturat përkatëse si ZKSK, të cilat sigurojnë asistencë për studentët në drejtim të procesit mësimor, formimit akademik, zhvillimit të karrierës, etj. Institucioni mbledh mendimin e studentëve lidhur me stafin pedagogjik nëpërmjet formularëve përkatës. Në institucion funksionon sistemi i tutoriatit, i vënë në jetë me bashkëpunimin midis personelit akademik,</p> |

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

administrativ dhe studentëve.
Po ashtu, ekziston figura e Dekanit të Studentëve, që duhet luajë rolin e përcjelljes së problematikave përkatëse. Sikundër u theksua më lart, kjo figurë nuk njihej dhe ishte e paqartë nga studentët.
Nga kontaktet e tjera në institucion gjatë vizitave, studentët, stafi administrativ dhe personeli akademik, hodhën dritë mbi hapat praktikë që ndiqen gjatë përditësisë për trajtimin e një problemi që haset nga studenti, ku u vu re komunikim efikas dhe me qasje pozitive midis figurave përkatëse.
U vërejt se, sa i takon përkujdesjes, institucioni, vërtetuar nga vizita në të dhe dokumentacioni i administruar, tregon kujdes të posaçëm për studentët me aftësi ndryshe, në drejtim të përshtatjes së ambienteve fizike me nevojat e tyre, por dhe të zhvillimit të procesit të mësimdhënies e të shlyerjes së detyrimeve vjetore (provimeve). Mbështetje nga ana e institucionit, lehtësira nga pikëpamja financiare, është treguar dhe për studentët që nuk zotërojnë mjetet e nevojshme ekonomike. Institucioni rezulton të ketë lidhur një sërë marrëveshesh me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale. Praktikant kryhen nën mbikëqyrjen e pedagogëve përkatës; përgjegjësia për realizimin e tyre i përket departamentit dhe Dekanatit të FSHJMN. ZKSK mban kopje të dokumentacionit që vërteton praktikant e kryera.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Pranimi i studentëve që ndjekin Masterin e Shkencave në të Drejtë Publike pranë UMSH është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 21/05/2007 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UMSH dhe Rregullorja e programit
2. Përzgjedhja e kandidatëve vijon pas procedurës së shpalljes, nga një komision i caktuar nga dekani, bazuar në dokumentacionin e përfshirë në dosjen personale të kandidatit.
3. Në regjistrin e miratuar nga Ministria e Arsimit, të administruar nga sekretaria mësimore e institucionit, janë pasqyruar në mënyrë të rregullt të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike.
4. Të dhënat në regjistër janë në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, gjë e cila rezultoi pas kontrollit të tyre, sipas një përzgjedhjeje të rastësishme. Në regjistër nuk janë plotësuar të dhënat lidhur me gjuhën e huaj dhe nivelin përkatës, që zotëron studenti, në kolonën e veçantë të krijuar për këtë qëllim, edhe pse në dosjen personale të regjistrimit të studentit gjendet certifikata/dëshmia e njohjes së gjuhës.
5. Studentëve u jepet informacioni dhe këshillimi i duhur për karrierën nga Zyra përkatëse e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe nga struktura të tjera të ngritura brenda UMSH siç është Dekani i Studentëve. Duhet evidentuar se nga takimi i zhvilluar me studentët në institucion, ata nuk e njihnin figurën e Dekanit të Studentëve dhe e perceptonin si dekanin e fakultetit.

6. Institucioni zotëron të dhëna të sakta sa i përket numrit të studentëve të diplomuar sipas programeve që kanë ndjekur, për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara. Të dhënat gjenden në sekretarinë mësimore dhe në zyrën e statistikave.
7. Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët edhe pas diplomimit të tyre dhe favorizon punësimin e studentëve që kanë ndjekur studimet në të e i kanë përfunduar ato me rezultate të larta.
8. Në UMSH është krijuar Klinika Ligjore “Mesdhetari”, një ndër qëllimet e të cilës është aftësimi praktik i studentëve të drejtësisë. Institucioni mban të dhëna edhe për studentët që vazhdojnë studimet në ciklet e tjerë të studimeve, duke u përpjekur që të krijojë mundësi punësimi të tyre dhe brenda institucionit.
9. Institucioni tregon kujdes të posaçëm për studentët me aftësi ndryshe, në drejtim të përshtatjes së ambienteve fizike me nevojat e tyre, por dhe të zhvillimit të procesit të mësimdhënies e të shlyerjes së detyrimeve vjetore (provimeve). Mbështetje nga ana e institucionit, lehtësira nga pikëpamja financiare, është treguar dhe për studentët që nuk zotërojnë mjetet e nevojshme ekonomike.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Në aktet e brendshme të UMSH vihet theksi në realizimin e kërkimit shkencor dhe rrugët për shtimin dhe ngritjen cilësore të kësaj fushe mjaft të rëndësishme e domethënëse të veprimtarisë së një IAL. Synimi për arritje pozitive në këtë fushë konstatohet qartë si nga strukturat drejtuese të institucionit, ashtu dhe nga stafi i pedagogëve. Së pari, janë përpjekjet dhe puna e vetë pedagogëve, të cilët përpiqen të përfshijnë dhe studentët në punën kërkimore, së dyti janë lehtësitë që institucioni iu ka krijuar pedagogëve për të marrë pjesë në veprimtaritë e kërkimit shkencor dhe së treti janë marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit dhe kontaktet e krijuara me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, tri drejtimet kryesore që vërtetojnë përpjekjet pozitive sa i përket këtij standardi. Qendra Kërkimore e ngritur në UMSH vepron në bazë të një strategjie të përcaktuar kërkimore. Veprimtaria kërkimore e këtij universiteti pasqyrohet në revistën e botuar prej tij, “Euromediterranean”, si dhe nëpër revista të tjera, vendase dhe të huaja. Kjo revistë botohet që nga viti 2010. Duke nisur nga muaji Nëntor 2009, UMSH është anëtar i Euro-Mediterranean University (EMUNI), gjë e cila ka krijuar mundësinë e publikimit të punimeve në revistën e tij, International Journal of Euro-Mediterranean Studies. Që nga viti 2010, UMSH është anëtar me të drejta të plota i EURAS (Unioni i Universiteteve dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë), që nxit bashkëpunimin e më tepër se 60 universiteteve të Evropës dhe Azisë. Ka përpjekje jo të dukshme për përfitimin nga projektet e programit Erasmus. Sa i përket programit të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Publike, puna kërkimore është e përqendruar kryesisht në ato degë së të drejtës që lidhen thelbësisht me të si, e drejta kushtetuese, e drejta administrative, e drejta e komunitetit evropian, të drejtat e njeriut, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Nga materiali i vënë në dispozicion rezulton se përgjatë periudhës Shtator 2016-Mars 2019, nga personeli akademik efektiv i UMSH janë realizuar gjithsej 339 botime shkencore. Janë fituar 9 projekte kërkimore dhe zbatuar po 9 të tilla. UMSH ka organizuar gjatë kësaj periudhe kohore 7 aktivitete shkencore, ku numri i pjesëmarrësve ka qenë 224. Në kërkimin shkencor janë përfshirë 94 studentë. Në numrin e çmimeve ndërkombëtare përshihen çmime të marrë nga anëtarë të personelit akademik që ndjekin studime të doktoraturës jashtë vendit, falë dhe mbështetje nga institucioni.







Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion


Aktet e brendshme të institucionit, RVB, Përmbledhje e punës shkencore e FSHJMN, Agjenda e aktiviteteve me studentë dhe pedagogë, Evidencë financim punimet shkencore, Raport vetë-vlerësimi për punimin shkencor, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|---|
| Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve. | |
| Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; | Shqyrtimi i akteve të brendshme të UMSH si dhe i dosjeve personale të pedagogëve nxjerr në pah se personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore vendase dhe të huaja, gjithashtu janë publikuar dhe disa artikuj e materiale shkencore. Puna kërkimore dhe botimet lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi. |
| Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. | Puna kërkimore e personelit akademik synon në përpunimin e mendimeve për zhvillimin e studimeve në fushat e së drejtës që përfshihen në programin e studimit dhe më tej. Punimet reflektojnë në përmbajtjen e tyre dhe analizën e ndryshimeve më të fundit kushtetuese e ligjore në Shqipëri, por dhe të ngjarjeve politike aktuale që përfshijnë rajonin dhe më gjerë, duke kontribuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe analitik. |
| Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar. | |
| Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikate për njohje të avancuar të saj; | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion është konstatuar se në programin në proces riakreditimi është përfshirë lënda "Metodat e kërkimit shkencor" me pedagog të huaj. Mësimdhënia është realizuar në gjuhën angleze. Për shkak të përdorimit të termave teknikë ligjorë, pedagogu tjetër ka ndihmuar me anë të përkthimit të tyre. |
| Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri. | Lënda është përfshirë në planin mësimor 2018-2019. |
| Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. | |
| Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; | Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i UMSH për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, por dhe organizimi i programeve të caktuara nga vetë institucioni. U evidentua zhvillimi i takimeve pranë UMSH, ku janë ftuar disa herë figura të spikatura në fushën e drejtësisë për të shkëmbyer ide dhe përvoja me kolegët e tyre. Vetë institucioni ka realizuar zhvillimin e një |



| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p> | <p>sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si, konferenca, seminare, leksione të hapura me figurat më në shtë të fushës së të drejtës, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Nga bisedat e zhvilluara, doli në pah vullneti institucional për të fituar disa projekte të rëndësishme, në të cilët është aplikuar.</p> <p>Nga bisedat e bëra me pedagogët, por dhe nga aktet e brendshme të institucionit, rezultoi më së miri se ky i fundit u ka krijuar lehtësi nga më të ndryshme për të kryer kualifikime brenda dhe jashtë vendit. Disa pedagogë vazhdojnë studimet doktorale jashtë vendit, duke mos pasur asnjë pengesë financiare apo të çdo lloji tjetër nga UMSH, materializuar këto të dhëna në pasqyrën e financimit faktik për punën kërkimore shkencore.</p> |
| <p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p> | <p>Institucioni zotëron të dhëna të sakta sa i përket punimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike. Të dhënat administrohen në dosjet përkatëse të secilit vit akademik, mbi publikimet shkencore të personelit akademik. Nga një kopje e punimeve të ndryshme depozitohet në zyrën e burimeve njerëzore, në bibliotekën e UMSH si dhe në format elektronik pranë Qendrës së Kërkimit Shkencor të këtij universiteti.</p> <p>Të dhënat që zotëron institucioni për botimet përfshijnë të dhëna lidhur me tekstet, monografitë, librat, artikujt, kumtesa në konferenca, brenda dhe jashtë vendit, që u përkasin anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program. Këto të dhëna vlejné dhe merren në konsideratë nga Njësia dhe Zyra e Burimeve Njerëzore për vlerësimin e performancës dhe rinovimin e kontratës së punës me anëtarët e këtij personeli.</p> <p>Institucioni disponon bazën e të dhënave edhe sa i përket projekteve kërkimore shkencore, të nivelit kombëtar e ndërkombëtar, në të cilët kanë qenë pjesëmarrës anëtarët e personelit akademik, të angazhuar në këtë program studimi. Projektet e plotë dhe të dhënat lidhur me ta janë të depozituara në zyrën e projekteve, e cila funksionin si strukturë në UMSH.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> | |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni i siguron personelit akademik informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, duke realizuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si, konferenca, seminare, leksione të hapura me figurat më në zë të fushës së të drejtës, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. 2. Personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore vendase dhe të huaja, gjithashtu janë publikuar dhe disa artikuj e materiale shkencore. | |




3. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ngjashme publikë dhe jopublikë, me synim shkëmbimin në fushën akademike. Përprojekjet në drejtim të aplikimit për fitimin e projekteve nëpërmjet programit Erasmus duhet të shtohen.
4. Institucioni zotëron të dhëna të sakta sa i përket punimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike. Gjithashtu disponon bazën e të dhënave edhe sa i përket projekteve kërkimore shkencore, të nivelit kombëtar e ndërkombëtar, duke u përdorur këto të fundit edhe për vlerësimin e performancës dhe rinovimin e kontratës së punës me anëtarët e këtij personeli.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Në drejtim të përmbushjes së qëllimeve në fushën akademike, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjerë vendas dhe të huaj. Bashkëpunimi është krijuar jo vetëm me universitetet, por dhe me institucione e struktura të shërbimit publik dhe privat, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim mbështetjen e programeve të studimit që ofron institucioni. Ndër marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar spikat ato me Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme, Kuvendin, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Ministrinë e Arsimit; në nivel ndërkombëtar me London Academy of Diplomacy, marrëveshje këto që kanë pasur vlerë të veçantë për programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike për kryerjen e praktikave nga studentët, por dhe për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca të përbashkëta. UMSH ka marrëdhënie të vazhdueshme me universitete anëtarë të EMUN, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Marrëveshje të shumta janë lidhur dhe me subjekte të ndryshme brenda vendit për qëllime të kryerjes së praktikave nga studentët, por dhe të sigurimit të informacioneve të vlefshme për qëllime të punësimit të tyre e konkretisht me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë Tiranë, Aleancën e Biznesit të Kosovës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit.

Në përputhje me nenin 38, gërma i, të Statutit të UMSH, nenin 67/3-6 të Rregullores së Organizimit të UMSH, nenet 14, gërma i dhe 45/1-6 të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 8, gërma i, të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Departamentit të së Drejtës Publike, në kuadër të programit praktika është realizuar në institucione të tilla si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritetit, etj., sipas rekomandimit të lënë nga BA. Kryerja e praktikës në këta institucione vërtetohet me dokumentacionin përkatës të depozituar pranë Përgjegjës të departamentit dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës.



Institucioni nxit angazhimin e studentëve në punë shkencore individuale nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në aktivitetin vjetor të organizuar nga UMSH, "Panairi i ideve", nëpërmjet referimeve apo projekteve të përbashkëta me universitete të tjerë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)

Referuar të dhënave të pasqyruara në RVB, gjatë periudhës Shtator 2016-Mars 2019, paraqiten këto aktivitete:

| | |
|---|--------|
| Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare | 3 |
| Numri i leksioneve/seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore | 60 orë |
| Numri i pjesëmarrësve në trajnime, fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit | 5 |
| Numri i studentëve që kanë përfituar nga projektet Erasmus+ | 3 |
| Numri i pjesëmarrësve në aktivitete jashtë UMSH/jashtë vendit | 29 |
| Numri i çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor | 1 |

Sa i përket infrastrukturës në funksion të kërkimit shkencor përbëhet nga biblioteka, abonimi në Questia online, fondi prej 327325 tituj elektronikë, laborator IT, laborator i gjuhës së huaj, laborator i statistikës, salla e konferencave, revista Euromediterranean.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë


Të dhënat e vëna në dispozicion vënë në dukje bashkëpunimin dhe komunikimin me një numër të konsiderueshëm universitetesh vendas dhe të huaj si UT, UB, Universiteti Politeknik i Tiranës, universitete të Italisë, Francës, Anglisë, Rumanisë, si University of East Anglia, Università di Calabria, University of Social Sciences Lodz, University of Craiova, Romania, EMUNI University Slovenia, University of Nis, Serbia, Sigmund Freud University of Paris, CEMAS Sapienza, Università di Aldo Moro Bari, etj., me institucione si Akademia e Shkencave, Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Akademia e Londrës, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, AMF, Kuvendi, KLSH, Komisioneri për të drejtën e informimit, gjykata e bashki, etj., përfaqësues të ndryshëm të komunitetit të biznesit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Aktet e brendshme të institucionit, strategjitë, marrëveshjet e bashkëpunimit, RVB, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|--|
| Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij. | |
| <p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p> | <p>Nga aktet e shqyrtuara dhe vizita në institucion rezultoi që gjatë programit të studimeve Master i Shkencave në të Drejtë Publike, institucioni ka mundësuar kryerjen e praktikave mësimore me institucione dhe organizata të ndryshme, me të cilët ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi. Gjatë semestrit të dytë të vitit II të programit Master i Shkencave në të Drejtë Publike, mundësohet kryerja e Internship dhe infrastruktura përkatëse për zhvillimin e saj.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme, Kuvendin, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Ministrinë e Arsimit; në nivel ndërkombëtar me London Academy of Diplomacy, marrëveshje këto që kanë pasur vlerë të veçantë për programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike për kryerjen e praktikave nga studentët, por dhe për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca të përbashkëta. UMSH ka marrëdhënie të vazhdueshme me universitete anëtarë të EMUN, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Marrëveshje të shumta janë lidhur dhe me subjekte të ndryshme brenda vendit për qëllime të kryerjes së praktikave nga studentët, por dhe të sigurimit të informacioneve të vlefshme për qëllime të punësimit të tyre e konkretisht me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë Tiranë, Aleancën e Biznesit të Kosovës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, Dhomën e</p> |




| | |
|---|--|
| | <p>Avokatëve të Shqipërisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit.</p> <p>Në përputhje me rekomandimet e lëna praktika është realizuar në institucione të tilla si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit, etj.</p> |
| <p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p> | <p>Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis personelit akademik, administrativ dhe strukturave drejtuese, është një element që u konstatua gjatë vizitës në institucion. Programi është hartuar nga personel akademik i kualifikuar dhe shkëmbimi i informacionit ka qenë efikas në drejtim të hartimit të programit dhe të vënies në jetë të tij.</p> <p>Nga bisedat e zhvilluara me personelin akademik në institucion rezultoi që aktiviteti i departamentit të së drejtës publike diskutohet në mënyrë sistematike në mbledhjet e departamentit dhe të fakultetit. Në këto mbledhje, bëhet ndarja e punës për secilin anëtar të personelit akademik; detyrat dhe përgjegjësitë janë të formalizuara dhe në aktet e brendshme të institucionit. Në këto mbledhje diskutohen dhe nevojat e lindura, problemet e hasura, gjë që ka sjellë në vijimësi përmbushjen në mënyrë të efektshme të detyrimeve nga anëtarët e personelit akademik.</p> |
| <p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> | <p>Rezultoni nga aktet e shqyrtuara dhe vizita e realizuar në institucion, se nga ana e UMSH janë shtuar marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, vendase dhe të huaja, të tilla si UT, Universiteti Bujqësor e Politeknik të Tiranës, universitete të ndryshme të shteteve të Italisë, Anglisë, Francës, vendeve të rajonit, etj. Gjithashtu, janë vendosur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë Tiranë, Aleancën e Biznesit të Kosovës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit, etj.</p> <p>Institucioni ka avancuar në forcimin e bashkëpunimit me subjekte të njohur të biznesit, në Shqipëri e më gjerë, për të mundësuar krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin. Strukturat e institucionit kanë vendosur linjat e komunikimit me subjekte private e publike që kanë interes për punësimin e studentëve të diplomuar në programin Master i Shkencave në të Drejtën Publike. Nga takimet dhe aktet e shqyrtuara nga GVJ gjatë vizitës, u evidentua se institucioni vepron në mënyrë aktive për të mundësuar financiarisht e në mënyra të tjera pjesëmarrjen në trajnime dhe aktivitete të ndryshme akademike, brenda dhe jashtë Shqipërisë të personelit akademik, por dhe të studentëve.</p> <p>Marrëveshjet e nënshkruara i janë nënshtruar analizave përkatëse, në mënyrë që të shndërrohen në efikase për qëllimin për të cilin janë lidhur, duke nxjerrë në pah rezultatet faktike që kanë prodhuar dhe dobishmërinë në programin e studimit.</p> |

Arta Durrës

[Signature]

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni shfaq në mënyrë të dukshme vullnetin pozitiv për rritjen profesionale të anëtarëve të personelit akademik dhe të ushtrimit praktik të studentëve që ndjekin programin Master i Shkencave në të Drejtë Publike, falë marrëveshjeve të shumta që UMSH ka lidhur me universitetet, por dhe me institucione e struktura të shërbimit publik dhe privat. Gjithashtu, pasqyrohet dhe në mbështetjen financiare dhe infrastrukturore për qëllime të rritjes profesionale.
2. Brenda institucionit janë krijuar strukturat e duhura që mbajnë kontaktet e nevojshme me institucionet bashkëpunuese e më gjerë, me qëllim pjesëmarrjen dhe shtimin e punës shkencore, organizimin e veprimtarive shkencore dhe botimet në revistat shkencore.
3. Institucioni ka shtuar marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, vendase dhe të huaja, si dhe ka vendosur marrëdhënie të frutshme bashkëpunimi me subjekte të njohur të biznesit, në Shqipëri e më gjerë, për të mundësuar thellimin e njohurive dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin. Në përputhje me rekomandimet pas akreditimit të parë, institucioni ka lidhur marrëveshje për kryerjen e praktikës pranë Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, etj., praktika të cilat lidhen me fushën e programit të studimeve.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

(Grupi shprehet për plotësimin/mosplotësimin/plotësimin e pjesëshëm të rekomandimeve)

GVJ ka kontrolluar dhe vlerësuar punën e bërë nga IAL-ja në lidhje me akreditimin e fundit. Institucioni ka reaguar pozitivisht dhe ka shfaqur vullnet për plotësimin e detyrave të lëna, duke bërë parashikime të qarta në aktet e brendshme të funksionimit të tij, me qëllim ndarjen e barabartë të krediteve prej 60 të tilla në çdo vit studimi; ka realizuar ndryshimet përkatëse në aktet e brendshme të UMSH, ku parashikohen funksioni dhe detyrat konkrete të Koordinatorit të Programit të Masterit, duke u qartësuar roli i Koordinatorit dhe në ndryshimet strukturore brenda fakultetit; institucioni ka bërë ndryshimet e nevojshme në aktet e brendshme të funksionimit të tij, ku është parashikuar pjesëmarrja e Përgjegjës të Departamentit në procesin e rekrutimit të personelit akademik, në mënyrë të detyrueshme; janë bërë ndryshime në aktet e brendshme të tij e për rrjedhojë, në kuadër të programit, praktika është realizuar në institucione të tilla si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit, etj.

Në këtë kuptim, GVJ vlerëson se rekomandimet janë plotësuar nga ana e IAL.


Aspekte të tjerë të përmirësuar lidhen me rritjen e cilësisë dhe e numrit të pedagogëve, të cilët përbëjnë stafin akademik. Kjo ka sjellë si pasojë rregullimin e kritereve të nevojshëm për të qenë në standartet ligjorë. Nga ana tjetër, struktura e përshtatshme dhe mjetet ndihmëse mbeten të një cilësie të lartë Nisur nga këto elementë, studentët janë shprehur të kënaqur nga kushtet e ofruara nga UMSH sa i përket formimit të tyre.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. UMSH ka vizion të qartë e Strategji zhvillimi në përputhje me kërkesat e tregut për të cilat ofrohet programi “e Drejtë Publike”. Drejtimit e përcaktura në aktet rregullative të institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të programit janë të orientuara saktë e me perspektivë të qartë, duke i shërbyer efektivisht punës akademike.
2. Stafi drejtues i Fakultetit paraqet eksperiencë të thelluar, si në fushën juridike, si në drejtim, duke orientuar punën organizative dhe akademike me profesionalizëm të lartë.
3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave ka rritur standartin e saj duke monitoruar cilësinë por duke shërbyer edhe si forcë shtytëse për një performancë në rritje, për çdo individ por edhe në nivel institucional.
4. Institucioni ka treguar vullnet për të përmbushur në kohën dhe rrugën e duhur rekomandimet e lëna nga akreditimi i kryer për herë të parë, duke përmirësuar aspektet e mangëta të evidentuar në to si dhe në tërësi veprimtarinë e tij, në funksion të programit objekt vlerësimi dhe më gjerë;
5. Infrastruktura e institucionit është bashkëkohore, cilësore e funksionale dhe ndihmon në përmbushjen efikase të programeve dhe veprimtarisë së tij. Vlen të përmendet dhe literatura që ofrohet në bibliotekën e institucionit, fizike dhe online, e cila ndihmon në punën dhe kërkimin shkencor;
6. Programi Master Shkencor në të Drejtë Publike paraqet vlera mjaft pozitive për nga mënyra si është konceptuar e zbatohet, përsa i përket personeli akademik që ofron dijet e tij në këtë program, mundësitë që u krijon në tregun e punës studentëve që e ndjekin si dhe mundësitë për kualifikime të mëtejshme;
7. Krijimi i strukturave të dobishme për praktikimin e dijeve të studentëve dhe për përfitimet që sjellin në komunitet, si Klinika Ligjore;
8. Personeli akademik dhe stafi administrativ i UMSH kanë qasje pozitive ndaj studentëve, spikatin për një bashkëpunim të mirë mes tyre dhe për zgjidhjen me efikasitet të problemeve, duke marrë përsipër edhe detyra të tjera, në funksion të çuarjes përpara të veprimtarisë së institucionit;
9. Qasja pozitive vërehet dhe ndaj disponueshmërisë që ka institucioni për të mos u mohuar vazhdimin e dijeve edhe studentëve me probleme ekonomike apo atyre me aftësi ndryshe;
10. Marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit të lidhura me institucione të ngjashme, institucione qeveritare dhe komunitetin e biznesit.



b. Pika të dobëta:

1. Institucioni nuk i është nënshtruar vlerësimit nëpërmjet ekspertizës jashtë Institucionit për vlerësimin e programeve të studimit dhe cilësinë akademike, duke kufizuar një burim të mundshëm për rritjen e mëtejshme Institucionale.
2. Jo të gjithë syllabuset janë të përditësuar dhe të unifikuar në pikëpamje të modelit, në përputhje me modelin që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.
3. Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është ende i ulët.
4. Mosshfrytëzimi si duhet i kapaciteteve që zotëron institucioni dhe mosnjohja e plotë e tyre nga përfituesit kryesorë që janë studentët, siç është rasti i Dekanit të studentëve, Klinikës Ligjore, bibliotekës online;
5. Përfitimi i paktë nga programet Erasmus;

c. Mundësitë:

1. Rritja dhe përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, duke krijuar mundësi thellimi në aspektet praktike të së drejtës dhe duke krijuar bazat e një bashkëpunimi më të zgjatur në kohë, duke krijuar ura komunikimi edhe me studentët alumni.
2. Gjithashtu shfrytësimi i mundësive për avancimin e anëtarëve efektivë të personelit akademik për t'u rritur më tej në drejtim të kualifikimit shkencor, por gjithashtu edhe në drejtim të kualifikimeve të mëtejshme në shkëmbime akademike e profesionale me Universitete të huaja të spikatura në fushën e drejtësisë.
3. Institucioni ka mundësi të mira për të çuar përpara programet e studimit në drejtim të thellimit të tyre, për shkak të kualifikimit të personelit akademik dhe përmirësimit të mëtejshëm të kurrikulës mësimore, pasi ka theksuar studimin e degëve të së drejtës publike;
4. Institucioni disponon mjetet e nevojshme për rritjen profesionale të personelit akademik, por dhe të aftësive të studentëve, duke nxitur pjesëmarrjen dhe përfitimin sidomos nga programet që ofrojnë kualifikime dhe kërkimin shkencor jashtë vendit;
5. Institucioni ka kushtet e nevojshme për të rritur marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, sidomos të vendeve të zhvilluara, si dhe për të organizuar aktivitete shkencore, shtimin e lëndëve mësimore në gjuhë të huaj, etj.

d. Pengesat:

1. Jemi të mendimit se institucioni është plotësisht në gjendje të përmbushë ato që konsiderohen pika të dobëta nga ana jonë. Nga institucioni vetë konsiderohen pengesa ndryshimet e shpeshta në legjislacionin që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.




e. Rekomandimet kryesore sipas raportit:

1. Në përputhje me aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi, duhet rregulluar ngarkesa mësimore e lektorëve, duke përshtatur edhe bazën rregullative të Institucionit, si edhe kontratat.
2. Në kuadrin e uniformimit me praktikën e mira të punës, ashtu siç ndodh me aspektet financiare të Institucionit ku kontraktohen auditues të jashtëm, në të njëjtën logjikë duhet përdorur ekspertiza e jashtëme e profesionistëve më të mirë në fushën akademike, për vlerësimin e programeve të studimit dhe cilësinë akademike.
3. Syllabus-et duhet të përditësohen dhe të unifikohen në pikëpamje të modelit nga të gjithë pedagogët, në përputhje me modelin që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;
4. Në regjistrin mësimor duhet të plotësohen të dhënat lidhur me gjuhën e huaj dhe nivelin përkatës, që zotëron studenti, në kolonën e veçantë të krijuar për këtë qëllim;
5. Duke qenë se institucioni ka krijuar strukturat e nevojshme të tij, duhet të bëhet një punë më e mirë lidhur me njohjen e tyre prej studentëve, siç është rasti i figurës së Dekanit të Studentëve;
6. Duhet të shtohen përpjekjet në drejtim të aplikimit për fitimin e projekteve nëpërmjet programit Erasmus;
7. Institucioni duhet të bëjë të mundur njohjen e gjerë të shërbimeve të tilla si Klinika Ligjore, me qëllim shtimin e veprimtarisë së tyre, në dobi jo vetëm të studentëve, por dhe të përfituesve prej saj.

SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

The External Evaluation Group (EEG) has checked and evaluated the work done by the High Education institute (HEI) concerning the last accreditation. The institution has reacted positively and has expressed willingness to fulfill the assigned duties by clarifying in the internal acts about its functioning, with the aim of equating the credits in 60 each year of study; has implemented the relevant amendments in the Mediterranean University of Albania's (MUA) internal acts, which prescribe the function and tasks of the Master Program Coordinator, clarifying the role of the Coordinator and structural changes within the faculty; the institution has made the necessary amendments in the functioning internal acts, being envisaged the mandatory participation of the Head of Department in the process of recruitment of academic staff; amendments have been made to its internal acts regarding the student's practitioner and, as a result, the practice has been implemented in institutions such as the Assembly, the Ministry of Justice, the Ministry of Integration etc.

In this sense, the EEG estimates that the recommendations have been fulfilled by the HEI. Other improved aspects relate to increasing the quality and the number of lecturers who make up the academic staff. This has led to the regulation of the necessary criteria to be in line with legal standards. On the other hand, the appropriate structure and auxiliary tools remain of a high quality. Based on these elements, students expressed their satisfaction with the conditions offered by MUA regarding their formation.



SUMMARY ANALYSIS OF THE EEG BY THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strengths:

1. MUA has a clear vision of its Development Strategy in accordance with the market requirements for which the "Public -Law" program is provided. The guidelines set in the institution's regulatory acts and the program development strategy are accurate and clearly-oriented, with effective perspective in the academic's work service.
2. The management of the Faculty has deep experience, both in the field of law and in management, guiding the organizational and academic work with high professionalism.
3. The Internal Quality Assurance and Curriculum Development Unit has increased its standards monitoring the Institution's quality but also serving as a driving force to increase the performance of each individual as well as at institutional level.
4. The institution has shown the willingness to meet in the timing and track the recommendations left by the accreditation the first time, improving the deficiencies identified in them as well as the whole of its activity, in function of this program object of evaluation;
5. The infrastructure of the institution is modern, qualitative and functional helping the efficient performance of its programs and activities. It is worth mentioning that the literature provided in the library of the institution, both physically and online, which helps in the research work;
6. The Master's degree program in Public Law grants a very positive value in the way it is conceived and implemented, especially with regard to the academic staff part of this program, regard the opportunities it creates in the labor market, regard the students who follow it and the opportunities for further qualification;
7. Creating useful structures to students education and benefits towards the community, such as the Legal Clinic;
8. Academic staff and administrative staff of MUA have a positive attitude towards the students; they emphasize a good cooperation between them, solving the problems efficiently, taking on also other tasks functionally to the stepping forward of the institution;
9. A positive approach is also noted to the institution's accessibility towards students with economic problems or those with different abilities;
10. Numerous cooperation agreements related to parallel institutions, government institutions and the business community.

b. Weaknesses:

1. The institution has not been subject to evaluation through external expertise regarding the study programs and the academic quality, limiting a potential source for further institutional growth.
2. Not all syllabus are updated and unified in the model's view, in accordance with the model that is part of DCM no. 41, dated 24/01/2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions.
3. The number of students involved in the research is still low.
4. The lack of proper use of the capacities of the institution and their complete lack of knowledge by the main beneficiaries who are the students, such as the students dean, the Legal Clinic and the online library;
5. Low benefit from Erasmus programs;



c. Opportunities:

1. Raising and involving students in research, creating opportunities for deepening the practical aspects of the law and creating the basis for a more prolonged cooperation in time, creating communication bridges with alumni students.
2. Also developing opportunities for members of academic staff to further increase in terms of scientific qualification, but also in terms of further qualifications in academic and professional exchanges with foreign universities in the field of justice.
3. The institution has good opportunities to advance the study programs in terms of their deepening, due to the qualification of academic staff and the further improvement of the curriculum, as it has highlighted the study of the branches of public law;
4. The institution has the necessary resources for the professional growth of academic staff and students' skills, encouraging participation and benefit, in particular, of programs offering qualifications and research abroad;
5. The institution has the necessary conditions to enhance the cooperation relations with foreign institutions of higher education, especially of developed countries, as well as to organize scientific activities, to add foreign language courses, etc.

d. Threats:

1. We are of the opinion that the institution is fully able to fulfill its weak points by us. The institution itself considers a risk the frequent amendments in the legislation in the field of higher education and research.

e. Recommendations:

1. In the context good practices, as is the case with the financial aspects of the Institution where external auditors are contracted, the external expertise of the best professionals in the academic field, should be used to evaluate the study programs and academic quality.
2. Syllabus should be updated and unified in the model view of all teachers, in accordance with the model that is part of DCM no. 41, dated 24/01/2018 "On Elements of Study Programs Offered by Higher Education Institutions";
3. In the syllabus, the data relating to the foreign language and the respective level of the student, in the special column created for this purpose, must be completed;
4. In the basic registry, the data relating to the foreign language and the respective level of the student, in the special column created for this purpose, must be completed;
5. Since the institution has created its necessary structures, a better job should be done with regard to their acknowledgment by the students, as is the case of the dean of the students;
6. Efforts should be made to apply for project-based applications through the Erasmus program;
7. Institution should make possible the extensive recognition of such services as the Legal Clinic, in order to increase their activity to the benefit not only of students but also of its beneficiaries

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho

Dr. Bledar Mustafaraj